



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Raporti vjetor i Universitetit

2010-2011

Raporti vjetor i Universitetit është për periudhën nga 1 shtatori 2010 deri
31gusht 2011

Nëntor 2011
Tetovë,
Maqedoni

Table of Contents

1.0 Hyrje	4
2.0 Arritjet	5
3.0 Strukturat – Fakultetet dhe qendrat	7
3.1 Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë	7
3.2 Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore.....	8
3.3 Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit.....	9
3.4 Fakulteti Juridik.....	10
3.5 Fakulteti i administrimit publik dhe shkencave politike.....	11
3.6 Qendra për eMësim (The eLearning Center).....	12
3.7 Instituti i mjedisit dhe shëndetit	13
3.8 Qendra e gjuhëve	13
4.0 Sigurimi i cilësisë.....	14
5.0 Mësimdhënia dhe nxënia	16
5.1 Programet dhe statusi	16
5.2 Regjistrimi i studentëve.....	16
5.3 Shkalla e kalueshmërisë.....	18
5.4 Shkalla e diplomimit	21
5.6 Vlerësimi nga studentët	22
5.7 Qendra e karrierës.....	24
5.8 Asociacioni Alumni	26
6.0 Hulumtimi	26
7.0 Ndërmarrësi dhe zhvillim	27
8.0 Financat	28
9.0 Mjedisi në kampus dhe shërbimet	29
9.1 Përkrahja e studentëve.....	29
9.2 Departamenti i ngrhinave dhe mjedisi në kampus.....	29
9.3 Dega Shkup e Universitetit të Evropës Juglindore	30

9.4 Burimet njerëzore.....	31
9.5 Sistemet e informacionit	33
9.6 Biblioteka.....	34
9.7 Unioni i studentëve	35
9.8 Departamenti i sportit dhe rekreacionit.....	35
10.0 Konkluzionet.....	35
Materialet që janë konsultuar:.....	36
Anëtarët e komisionit për vetë-vlerësim.....	37

1.0 Hyrje

Raporti vjetor i Universitetit është për periudhën nga 1 shtatori 2010 deri 31 gusht 2011. Viti akademik filloi me inaugurimin e rektorit të Universitetit të Evropës Juglindore Prof. Dr. Zamir Dika, i cili u zgjodh nga Bordi i universitetit në qershor të vitit 2010, si dhe u inaugurua më 1 shtator 2010, në një ceremoni të veçantë ku morën pjesë stejkholderë të brendshëm dhe të jashtëm. Rektori, Prof. dr. Z. Dika e prezantoi Ekipin ekzekutiv të rektorit në përbërje: Pol Foster, zëvendësrektor dhe prorektor për çështje akademike (Provost); Xhevahir Mehmeti, sekretar i përgjithshëm; Abdylmenaf Bexheti, prorektor për ndërmarrësi dhe zhvillim; Blerim Reka, prorektor për hulumtime dhe marrëdhënie me publikun; si dhe Hedher Henshou, këshilltare ekzekutive për performancë dhe menaxhim të cilësisë.

Rektori Dika prezantoi qëllimet e tij për Universitetin në raportin UEJL 2.0, në të cilin parimet bashkëkohore të menaxhimit ishin të kombinuara me theks të vazhdueshëm në mësimdhënie dhe nxënie, sigurim të cilësisë dhe llogaridhënie (accountability).

Mjedisi i arsimit të lartë vazhdoi të jetë i ndërlikuar edhe gjatë kësaj periudhe. U bënë përpjekje që të ngrihet niveli i raporteve me qeverinë e cila mbështet institucionet e reja në lindje dhe në perëndim të vendit. Kohëve të fundit janë hapur kampuse të reja rajonale në disa qytete më të vogla. Universitetet private, fitimprurëse vazhduan të ekzistojnë, por te ato shënohet edhe numri i regjistrimeve në rënie. Arsimimi masiv ose masivizimi i arsimit duket se është prioritet i qeverisë gjatë kësaj periudhe, mirëpo kjo çon në situatën ku paraqiten më shumë vende për studentë në universitete se sa që është numri i nxënësve që përfundojnë shkollat e mesme në vend.

UEJL gjithashtu humbi një mik të dashur në këtë periudhë. Maks van der Shtul-in, i cili ndërroi jetë në prill të vitit 2011 në shtëpinë e tij në Holandë. UEJL, në shenjë respekti për mikun e madh mbajti një takim përkujtimor.

2.0 Arritjet

Senati dhe Bordi i Universitetit miratuan promovimin e disa anëtarëve të personelit akademik duke ndjekur një sistem "hibrid" të rregullores për promovim dhe punësimin ku procesi i vjetër ishte plotësuar me dosjet që përmbanin provat akademike të veprimtarisë shkencore dhe të rezultateve kërkimore, mësimore dhe të shërbimit.

Për herë të parë që nga themelimi, UEJL u mundësoi studentëve të regjistrohen për orët mësimore para fillimit të semestrit. Në dhjetor të vitit 2010, studentët e regjistruan orarin online për semestrin pranveror. Planifikimi i tillë mundësoi që studentët të angazhohen plotësisht në 15 javët gjatë semestrit.

Gjatë këtij viti, të gjitha rregulloret dhe procedurat akademike u rishkruan plotësisht, u edituan dhe u përditësuan me praktikën aktuale të arsimit të lartë. Rektori për këtë punë themeloi një komitet të udhëhequr nga provosti, dekanët dhe drejtorët, por kontribut të veçantë kanë dhënë edhe shumë anëtarë të stafit akademik dhe administrativ. Rregulloret, politikat dhe procedurat e reja janë miratuar nga Senati në qershor e korrik dhe kanë hyrë në fuqi nga 1 shtatori 2011. Ky set i rregulloreve të reja në thelb mbështet performancën bazuar në promovimin dhe arritjet akademike, promovimin e transparencës dhe pjesëmarrjen në vendimmarrje dhe skemën e re për Rangim, rroga dhe kompensime tjera, pastaj siguron bazën për mundësi të barabarta në matjen e punës vis-à-vis shpërblimit.

Këtë vit, UEJL ka kryer vlerësimin e jashtëm të programeve studimore në katër fakultete, që janë bërë nga profesorë të Universitetit të Indianës, Universitetit të Gracit dhe Universitetit të Pitsburgut. Qëllimi ishte që të përdoren vlerësimet në ridisejnimin e ofertave studimore dhe për të hapur një diskutim të gjerë mbi profilin e të diplomuarve që i nevojiten Maqedonisë në kontekst global. Vlerësuesit ishin të udhëhequr në këtë proces nga ana e termave të referencës dhe nga një templejtë për raportim për të lejuar që fokusi i kolegëve ndërkombëtarë të jetë në zbatim programeve nga të gjitha ciklet e studimeve duke përfshirë kahjen e karrierës së stafit dhe qëndrueshmërinë e ofertave akademike. Të gjitha raportet nga vlerësuesit e jashtëm gjerësisht u qarkulluan në fakultete, ku ata, gjithashtu, përgatitën raporte për implementimin e të njëjtit. Në Universitet janë mbajtur seminare për futjen e rezultateve nga të mësuarit në kuadrin e Kornizës nacionale të kualifikimeve të reja, si çelësi i suksesit.

UEJL ka vazhduar të ruajë cilësinë e lartë të programeve të studimit që ofrohen në gjuhë angleze, e cila gjë hap mundësi për hartimin e strategjisë së re për ndërkombëtarizimin e Universitetit, e cila është në proces të përgatitjes. Në këtë kontekst, duke përdorur avantazhin konkurrues të sistemit të informacionit, nëpërmjet përmirësimit të vazhdueshëm të Sistemit të menaxhimit të të nxënimit dhe sesioneve intensive të trajnimit për stafin tonë akademik për përgatitjen e programeve të studimit në mjedisin on-line, Universiteti arriti të përgatitë programin e parë "on-line" në rajonin më të gjerë. UEJL është lider në ofrimin e moduleve të përshtatura dhe të personalizuara për të studiuar stilet e ndryshme të jetesës dhe nevojat e studentëve tanë të ardhshëm.

Në këtë periudhë, kur universitetet në mbarë botën ishin të detyruara të veprojnë në kuadër të buxhetit të kufizuar dhe mbështetjen e drejtpërdrejtë të zvogëluar nga qeveritë, ato ishin të detyruara, pra të zhvillojnë struktura dhe burime të reja për të diversifikuar të ardhurat në bashkëpunim me industrinë, UEJL ka projektuar një qëllim të caktuar - të bëhet modeli i universitetit të gjeneratës së tretë (3GU). Nëpërmjet një strukture të dedikuar, të udhëhequr nga prorektori për ndërmarrësi dhe mbështetur nga Qendra për zhvillimin e biznesit, Qendra e karrierës, njësitë dhe iniciativat tjera, UEJL ka vazhduar të pasurojë portofolin sipërmarrës si në aspekt strukturor dhe cilësor, me projekte të kryera në bashkëpunim me bizneset lokale, por gjithashtu duke siguruar konsultime dhe mbështetje për institucionet arsimore, si dhe qasje për komunitetin në terren. Universiteti është bërë më i dukshëm në këtë aspekt dhe ka marrë vlerësim nga palët e interesuara (stakeholders). Me rëndësi është se bizneset e suksesshme lokale kanë kontribuar me fonde që do të caktohen për bursa për studentët e ardhshëm në UEJL. Kjo është edhe një dëshmi për mbështetjen e fortë të komunitetit lokal për UEJL, për cilësinë dhe misionin, por edhe sukses i parë modest për diversifikimin e të ardhurave .

Dekada e parë ishte dedikuar për zhvillimin e një modeli unik të mësimdhënies në Maqedoni dhe në rajon. Dekada e dytë do të shënohet me aktivitete për futjen në përdorim të këtyre arritjeve, së bashku me qëllimin e rritjes së kapaciteteve kërkimore në fusha specifike. Duke pasur parasysh përvojat pothuajse inekzistente në vend dhe instrumentet e dobëta nga qeveritë në rajon, në aspekt financiar apo logjistik, kombinuar me vështirësitë e komunitetit të biznesit, angazhimi për t'i dhënë hov rritës së shpejtë, do të jetë punë e vështirë. Por, UEJL ka vizion për të gjetur mundësi në këto kohë të vështira. Në këtë konteskt kemi krijuar një strategji të re për hulumtim dhe tani po përgatiten strukturat e reja për të identifikuar dhe për të mbështetur në mënyrë aktive hulumtuesit në Universitet. Baza e të dhënave operative për hulumtim u vu në funksion kah fundi i periudhës për të cilën raportojmë. Kjo paraqet skemën e mbështetjes individuale të hulumtuesve për pjesëmarrje në konferenca dhe për botim të studimeve në revista ndërkombëtare. Projekti i parë multidisiplinar hulumtues, i mbështetur nga bashkësia ndërkombëtare dhe qeveria u krye me sukses.

Cilësia vazhdoi të jetë shtylla kryesore në përpjekjet e UEJL-së të bëhet lider rajonal në arsimin e lartë. Përmirësimi i planifikimit efektiv dhe i menaxhimit u evidentua, në përputhje me procesin e miratimit dhe monitorimin e planveprimeve - akademike dhe administrative. Instrumentet për sigurimin e cilësisë, të tilla si procesi i vëzhgimit të mësimdhënies, vlerësimi nga studentët dhe proceset e vlerësimit të stafit u rishikuan dhe u përmirësuan. Qëllimi i transformimit të sigurimit dhe menaxhimit të cilësisë në drejtim të cilësisë si kulturë është mbajtur me këmbëngulje dhe angazhim. Iniciativat për aktivitetet sociale për të gjithë stafin e universitet ishin shumë të rëndësishme për pronësinë dhe ndërtimin e një komuniteti krenar të UEJL-së.

Puna e suksesshme e Institutit të mjedisit dhe shëndetit duhet të veçohet. Është për t'u theksuar, në këtë drejtim, projekti i mbështetur nga Ministria Italiane e Mjedisit, e cila rezultoi me Planveprimin klimatik (Climate Action Plan), plan ky i pari në një universitet në Ballkan dhe më gjerë. Po ashtu e një peshe të tillë është edhe ndërtesa e parë inteligjente që përdor burime energjie të ripërtitshme. Bordi i Universitetit tonë, në Planin strategjik ka projektuar qëllimin ambicioz - që UEJL të bëhet Eko-kampusi i parë në rajon.

Në këtë fushë UEJL është e vendosur të ecë përpara dhe të këmbejë përvojat me universitetet të tjera partnere në vend dhe stejkholderët tjerë.

3.0 Strukturat – Fakultetet dhe qendrat

Universiteti ka ruajtur strukturën formale nga periudha e mëparshme, me pesë fakultete që ofrojnë programe studimore në ciklin e parë dhe të dytë, si dhe dy qendra që ofrojnë përkrahje në mësim në gjuhëve, shkrimin akademik, dhe teknologjitë e informacionit: Fakulteti juridik; Fakulteti i administrimit publik dhe shkencave politike; Fakulteti i biznesit dhe ekonomisë; Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimit; Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore; Qendra e gjuhëve dhe Qendra E-Learning. Përveç kësaj, Instituti i mjedisit dhe shëndetit ka vazhduar të ofrojë programe studimore në ciklin e dytë si dhe lëndë zgjedhore për të gjithë studentët e UEJL.

3.1 Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë

Dekani i fakultetit të biznesit dhe ekonomisë (FBE) Dr. Izet Zeqiri, u emërua për një mandate tjetër në dhjetor të vitit 2010 dhe vazhdoi të ofrojë ekspertizë menaxheriale për Fakultetin. Fakulteti i BE u fokusua në përmirësimin e cilësisë në mësim përfshirë akreditimin e programit studimor të ri për studimet pasuniversitare në menaxhimin e shëndetësisë, i projektuar në përputhje me nevojat e tregut. Një program i ri studimi për studime pasuniversitare dhe një program për certifikatë në Ndërmarrësi dhe zhvillimin ekonomik lokal ka filluar me sukses dhe këtu janë regjistruar gjenerata e parë e studentëve. Të dhënat e regjistrimit për vitin e ri akademik 2011/12, tregojnë nevojën për të gjetur mënyra të reja për të promovuar këto programe. Programi i studimit është përgatitur dhe po implementohet në bashkëpunim me 17 universitete të tjera evropiane në kuadër të projektit Tempus. Përshkruesit dhe rezultatet nga të mësuarit për të gjitha programet e studimore janë përgatitur në tri gjuhë.

Në korrik të vitit 2010 fakulteti iu nënshtrua një vlerësimi të jashtëm të udhëhequr nga një anëtar i lartë nga Indiana University's Kelley School of Business dhe i mbështetur nga kolegët e 4 universiteteve evropiane për një madhësi dhe natyrë të ngjashme si UEJL. Në aspektin e cilësisë së programit, vlerësuesi i jashtëm komentoi se programi deridiplomik ka ofruar një grup të mirë të lëndëve për studentët – kombinimi i mirë i lëndëve nga gjuhët, bazat sasiore, bazat e teknologjisë dhe vëllimi i lëndëve janë anët forta të programit, por cilësia e përgjithshme e standardeve janë identifikuar si nën presion të rëndë pasi UEJL është ofruar me një kosto të lartë në rajon. Raporti, gjithashtu vë në dukje se barra financiare dhe presioni për të ofruar një shumëllojshmëri të gjerë të lëndëve zgjedhore ka çuar anëtarët e stafit, sidomos në nivelin më të ulët, për të dhënë mësim në shumë lëndë gjatë çdo semestri. Situata ka çuar që stafi mësimdhënës i fakultetit të mbajë mësim jashtë fushës së tyre të ekspertizës. Një problem është mungesa e renditjes së duhur të programit mësimor. Në aspekt të zhvillimit të stafit dhe hulumtimit komentet ishin:

"Mungesa e kulturës për hulumtim në drejtim të përfundimit të doktoraturës dhe publikimit të punimeve në revista hulumtuese paraqet një sfidë të vërtetë për shkollën e biznesit të UEJL për të arritur qëllimet e të larta." Vlerësuesi i jashtëm ka ndihmuar në mënyrë aktive në hartimin e kurrikulave të reja dhe programeve. Ai ka vënë në dukje se programi aktual "mbulon kërkesat themelore për diplomë në biznes. Por, programi duhet të zhvillojë praktikën aktuale nga i gjithë globi në aspektin e mundësive për specializim, mundësitë globale e të mësuarit më shumë përmes metodës eksperimentale dhe stilit të mësimdhënies që lejon studentët të praktikojnë problem-bazë të të mësuarit." Sipas pikëpamjes së vlerësuesit, studentët duhet të mbahen sipas standardeve më të larta në aspektin e performancës.

Programet studimore deridiplomike, pasdiplomike dhe të doktoraturës janë shqyrtuar nga stafi i fakultetit dhe procesi i ristrukturimit të tyre në bazë të ligjit të ri të arsimit të lartë dhe dorëzimin e programeve të reja studimore për akreditim ka filluar dhe udhëhiqet nga raporti i vlerësimit të jashtëm. U krijua bashkëpunimi me universitetet e ndryshme evropiane në programin e doktoraturës nga Ndërmarrësia dhe menaxhimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe pjesëmarrja në organizimin dhe akreditimin e studimeve.

Në aspekt të hulumtimit dhe zhvillimit, janë konstatuar pikat në vazhdim: realizimi i suksesshëm i projektit shkencor-hulumtues, 'largimi i intelektualëve (brain drain)' dhe roli i diasporës në promovimin e ndryshimeve në Ballkan' në kuadër të programit RRPP); përgatitja e ciklit të ardhshëm të projektit shkencor-hulumtues 'Analizat e përqendruara në mendimet e qytetarëve' (në bashkëpunim me UNDP); pjesëmarrja në realizimin e projektit shkencor-hulumtues '20 vjet nga Marrëveshja Kornizë të Ohrit'.

Gjatë kësaj periudhe, katër anëtarë të stafit akademik kanë doktoruar, kurse pesë të tjerë kanë aplikuar për doktoratë. Pjesa më e madhe e stafit kanë marrë pjesë në konferenca shkencore ndërkombëtare. Pesë anëtarë të stafit kanë filluar të ofrojnë trajnime për zhvillimin e biznes planeve në kuadër të projektit të menaxhuar nga Qendra për zhvillimin e biznesit. Katër anëtarët e stafit kanë filluar ofrimin e trajnimeve për punonjësit e kompanive lokale dhe nacionale. Fakulteti ka organizuar dhe ka menaxhuar një seminar për studentët e doktoratës. Mobiliteti i stafit u organizua - nëntë anëtarë të stafit për 2 javë ishin në vizitë studimore në vende të ndryshme evropiane, kurse një anëtar i stafit ishte në vizitë studimore për një muaj në Angli.

3.2 Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore

Dr. Bekim Fetaji u riemërua dekan në dhjetor 2010. Në janar 2010, vlerësuesi i jashtëm, Dr. Mathew Palakal, nga Indiana University - Universiteti Purdue në Shtetet e Bashkuara vlerësoi fakultetin. Vlerësuesi i jashtëm qëndroi për një javë në kampus duke bërë intervistimin e stafit dhe studentëve, si dhe takua me palët e interesuara. Bazuar në rekomandimet e tij, programet studimore deridiplomike dhe pasdiplomike u analizuan dhe procesi i përditësimit dhe përmirësimit i programeve filloi. Seancat përcjellëse mbi

rekomandimet nga vlerësuesi u mbajtën në Mavrovë në korrik, në mënyrë që të përmirësohet cilësia e programeve.

Fokusi gjatë kësaj periudhe ka qenë në përmirësimin e vizibilitetit të FSHTB dhe promovimin e programeve të fakultetit për të maksimizuar regjistrimet. Vizita në terren janë bërë me nxënës të komuniteteve të ndryshme dhe shkolla të mesme në Maqedoni, Serbi dhe Kosovë. Stafi SHTB ka mbajtur prezantime lidhur me fakultetin në përgjithësi në kuadër të Universitetit të Evropës Juglindore, si dhe ka kontaktuar më shumë se 1500 nxënës të shkollave të mesme në total. Për disa shkolla nga Maqedonia sidomos nga Tetova, janë organizuar takime të veçanta, duke përfshirë edhe demonstrime në Ndërtesën 816, rreth programimit, programimit të lojarve dhe programimit në celular.

Fakulteti është fokusuar në përmirësimin e cilësisë dhe zhvilloi një template të standardizuar për përmbajtjen e provimit dhe syllabuseve, përfshi vëllimin e punës të studentit në dhe jashtë klasës, dhe rezultateve të mësimit. Fakulteti ka organizuar disa seminare dhe trajnime për stafin mbi metodologjinë e mësimdhënies dhe përmirësimin e mësimdhënies në bashkëpunim me ISC (Qendrën për përkrahje të mësimdhënies). Punëtori për harmonizimin e planprogrameve dhe zhvillimin e kurrikulave janë organizuar. Zhvillimi i on-line aplikacioneve për informim janë krijuar për mbështetjen e administratës në forcimin e procesit të planifikimit strategjik.

Fakulteti ka vazhduar për të forcuar kontaktet me industrinë dhe punoi për të analizuar IT shkathtësitë e kërkuara nga industria në Maqedoni, nëpërmjet projektit të mbështetur nga USAID-it dhe CORONA. Fakulteti u përqendrua në forcimin e bashkëpunimit me ASSECO SEE dhe ka realizuar një program për certifikatë mjaft popullor rajonal në eBanking falas për studentët. Së bashku me SEAVUS fakulteti ka organizuar trajnime për studentët dhe mundësitë për bashkëpunimin të mëtejshëm janë të diskutuar, veçanërisht për punën praktike të studentëve tonë në këtë kompani. Fakulteti ka rritur bashkëpunimin me IT fakultetet e tjera të universiteteve në Maqedoni dhe rajon.

3.3 Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit

Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimit vazhdoi të jetë një vend rajonal i dijes dhe mësimit në fushën e gjuhëve, gjuhësisë, komunikimit, dhe studimit kulturor. Pas një kërkimi të gjatë, Dr Andrew Goodspeed u emërua dekan në dhjetor 2010. Ndër arritjet e vitit të kaluar akademik këto katër zhvillime janë të dukshme. Së pari, ka pasur një rritje të konsiderueshme në studimet e ciklit të dytë, duke e bërë këtë vit fakultetin më të madh me numër studentësh se sa vitet e mëparshme. Në të vërtetë, kjo është një pikë e krenarisë së veçantë që shumë nga nxënësit tanë nga studimet deriuniversitare, pas përfundimit të studimeve deridiplomike, kanë vendosur të qëndrojnë në të njëjtin fakultet për të ndjekur studimet e tyre të magistraturës. FGJKK ka organizuar konferenca të rëndësishme rajonale të organizuara nga departamentet (si, për shembull, konferencën "Elena Gjika dhe kultura shqiptare, '27 Maj, 2011), dhe pjesëmarrja e fortë në konferenca nga anëtarë të stafit në konferencat ndërkombëtare. Fakulteti ka lançuar një pilot program kundër-plagjiaturës, për të siguruar integritetin akademik të studentëve dhe të stafit. Ky program vazhdon. Studentët kanë marrë pjesë në mundësitë për mobilitet (si p.sh. në Universitetin e

edukimit “Central Switzerland - Zug, Schwyz, dhe Lucerne”) nga i cili ne kemi pranuar studentë dhe ku studiojnë studentët tanë.

Fakulteti ka kërkuar gjithashtu të sfidojë veten dhe është angazhuar të përparojë ofrimin e up-to-date dhe programet e dobishme, udhëzimin e cilësisë dhe mundësitë e zhvillimit të stafit. Secili departament (gjuhë shqipe, angleze, gjermane dhe komunikimi), kanë filluar procesin e shqyrtimit të plotë të programeve studimore, për të maksimizuar shërbimin e njohurive të paraqitura, dhe për të siguruar punësimin e të diplomuarve. Stafi akademik ka vazhduar të jetë i shquar në të gjithë komunitetin përgjatë gjithë vitit akademik.

3.4 Fakulteti Juridik

Fakulteti juridik priti një ekip të jashtëm vlerësues nga Universiteti i Grac-it (Graz) në shkurt të këtij viti. Të tre vlerësuesit kishin kompetenca të veçanta në fushën e së drejtës private, të drejtës publike dhe të drejtës ndërkombëtare dhe evropiane, si dhe në drejtimin e një programi master për integritet evropian. Ata ishin të shqetësuar se pse studentët nuk kanë përfunduar studimet e tyre të magistraturës dhe sugjeruan që administrata të sigurojë mbështetje më të mirë për studentët. Gjithashtu u rekomandua që modeli 3 +1 të ofrohet në ciklin e parë të studimeve për të lejuar të diplomuarit të konkurrojnë për punë në nivel vendor dhe evropian përveç nevojës për kompletimin e ciklit të dytë (3 +2). Vlerësimi i jashtëm gjithashtu vuri në dukje “rëndësinë e të drejtës evropiane dhe integritetit evropian në programet deridiplomike dhe pasdiplomike ku duhet të merret në konsideratë zgjerimi i dimensionit evropian i lëndëve të ofruara.” Ekipi gjithashtu sugjeroi që të gjitha lëndët e ofruara duhet të jenë më shumë të bazuara në hulumtime dhe të udhëhiqen nga personeli akademik i cili në mënyrë aktive boton në fushat e tyre të ekspertizës. Gjithashtu u komentua zhvillimi i stafit dhe pjesëmarrja në simpoziume dhe konferenca. E rëndësishme është se, në lidhje me kurrikulat, ekipi komento: “Kurrikulat e ofruara duhet të fokusohen më shumë në mënyrë që të dallohen nga fakultetet tjera. Përveç një fokusi më të madh në të drejtën evropiane duhet të ketë dallim më të madh mes programeve që ofrohen në nivel deridiplomik dhe pasdiplomik. Në veçanti, përsëritjet duhet të mbahen në minimumin e nevojshëm dhe metodologjia e mësimdhënies duhet të përbëhet nga një kombinim i ligjëratave dhe puna e pjesëmarrjes së studentëve me një fokus në metodologjinë shkencore dhe praktika/shkathësitë, për të cilin qëllim praktikuesit duhet të përfshihen.”

Një kërkim i brendshëm për dekan u realizua në nëntor të vitit 2010, ndërsa dekani aktual Dr. Ismail Zejneli u riemërua në dhjetor të vitit 2010. Ai përqendroi burimet e fakultetit për të sjellë shërbime më të mira për studentët, në veçanti për të rritur shkallën e diplomuarve në ciklin e dytë. Dekani u angazhua të sigurojë që i gjithë stafi akademik të mbajë orët rregullisht dhe të takohen me studentët. Stafi i fakultetit juridik ka qenë aktiv në konferenca vendore dhe rajonale dhe ka vazhduar të publikojë punën e tyre në revista të ndryshme vendore dhe rajonale. Programi i doktoratës është zhvilluar në bashkëpunim me Fakultetin e drejtësisë në Universitetin e Grac-it (Graz) të cilët ofruan të sigurojnë staf akademik për nevojat e UEJL-së.

Studentët e fakultetit juridik të UEJL-së vizituan institucione të ndryshme në Evropë. Numri i studentëve të diplomuar në të dy ciklet: në të parin dhe në të dytin është në rritje. Janë punësuar demonstratorë të rinj si një mundësi për përfshirjen e stafit të ri në procesin arsimor si dhe ndihmë për stafin senior akademik me IT burimet e reja (si e-grading, online mësimdhënie, etj.). Dekanati mori një rol aktiv në rekrutimin e studentëve të rinj dhe marketingun e fakultetit si një mjet për kundërveprim në rritjen e numrit të fakulteteve juridike në vend dhe në rajon. Me rëndësi të veçantë, ishte fillimi i një programi të përbashkët të magistraturës -Marrëdhënie ndërkombëtare mbështetur nga Zyra e TEMPUS-it.

3.5 Fakulteti i administrimit publik dhe shkencave politike

Fakulteti i administrimit publik dhe shkencave politike ka pësuar një ndryshim në udhëheqje gjatë kësaj periudhe. Në dhjetor të vitit 2010, pas një kërkimi të brendshëm dhe të jashtëm, dekan i ri u emërua Dr. Elena Andreevska. Në të njëjtën kohë një vlerësim i jashtëm i fakultetit është ndërmarrë nga një edukator i njohur ndërkombëtar në administratën publike. Një raport është dorëzuar nga eksperti-vlerësuesi i jashtëm Prof. Dr. William Dunn. Raporti ka dhënë analizë të çështjeve të ngritura nga stafi akademik dhe administratorët. Me këtë rast janë dhënë rekomandime për veprime të menjëhershme dhe afatgjata. Vërejtjet e ndihmuan fakultetin e APSHP për t'u mobilizuar në përpjekjen për të adresuar dobësitë dhe pikat e forta të theksuara në raport, ndërsa seriozisht janë analizuar sfidat e brendshme dhe të jashtme me të cilat mund të përballet departamenti në të ardhmen e afërt dhe të largët. Raporti siguroi bazë për një fillim të mirë të veprimit pjesëmarrës në krijimin e vizionit të përbashkët për departamentin dhe planin strategjik tre vjeçar. Vlerësimi i jashtëm komentoi: "Sukseset e ardhshme do të varen nga administrimi i problemeve nga ana e menaxhmentit të fakultetit, por ka të ngjarë të ketë një tranzicion të vështirë për t'u pranuar gjerësisht qëllimet akademike, standardet dhe procedurat, duke vazhduar pastaj me zgjedhjen e një përzjerjeje të duhur të studentëve në një universitet ndërkombëtar të respektuar, ku fliten tri gjuhë, por edhe duke intensifikuar përpjekjet për të zhvilluar kurrikula të reja dhe më të fokusuar, përvetësimin e kompetencave në gjuhën angleze nga stafi si dhe studentët, rekrutimin e stafit zëvendësues/të jashtëm të kualifikuar për të ndihmuar në zhvillimin dhe mësimdhënien e lëndëve të reja bazike, sigurimin e performancës së stafit të fakultetit duke inkorporuar mësimdhënien, hulumtimin dhe shërbimet në kontratë për punë, si dhe ndjekjet e mundësive për bashkëpunim ndërkombëtar në kërkimet shkencore, shkëmbime dhe studime të doktoratës."

Fakulteti ka bërë përparim të mirë në zhvillimin e programeve të reja bazuar në nevojat e tregut dhe të dorëzimit të bordit të akreditimit. Fakulteti ka themeluar grupe punuese për të reflektuar natyrën ndërdisiplinore të fushave akademike për përmirësimin e kurrikulave ekzistuese, përafrimin e rezultateve nga të mësuarit me lëndët që ofrohen në programet studimore. Grupet e punës, pra: politikat publike dhe menaxhmenti, e drejta kombëtare dhe ndërkombëtare, ekonomia, sociologjia dhe shkenca politike ishin në fazën e fundit të përgatitjes së ndryshimeve të programit. Aktivitetet e ndërmarra në këtë drejtim kanë qenë të bazuara kryesisht në rezultatet e raportit të vlerësimit të jashtëm, të dorëzuar në dhjetor të vitit 2010. Aktivitetet e rishikimit të kurrikulave janë orientuar kah procesi që përfshin të gjithë stafin akademik

të rishikimit të programeve mësimore në mënyrë që të adresohen nevojat e, kryesisht, organizatave qeveritare, publike dhe private.

Menaxhmenti i fakultetit është i fokusuar në angazhimin dhe përmirësimin e shërbimeve për studentët, për stafin dhe lëmenjtë në terren. Një qasje ndryshe e menaxhmentit për komunikim me stafin akademik u prezantua në drejtim të implementimit të mënyrës për fitbek (feedback) konstruktiv dhe aktiv nga stafi për proceset që lidhen me ecurinë e vendimmarrjes akademike. Stafi mësimdhënës është informuar në mënyrë të rregullt dhe në mënyrë efektive në lidhje me politikat e reja universitare, organizimin efektiv të këshillit të fakultetit, përpilimin e rendit të ditës për takimet; krijimin e ambientit miqësor për diskutime konstruktive, dhe vlerësimin e procesverbalit. Menaxhmenti i ri është fokusuar në transparencë me theks të veçantë në një transparencë më të madhe dhe komunikim të përmirësuar, duke përfshirë studentët në mënyrë aktive në takimet e këshillit dhe në ekipin e sigurimit të cilësisë dhe duke dëgjuar shqetësimet e nevojat e tyre me qëllim të përgjithshëm të përmirësimit të procesit mësimor. Si fakultetet tjera FAPSHP ka punuar në përafrimin e deskriptotëve të lëndës me ekspertizën e ligjëruesve. Dekanati ndërmoi një seri iniciativash me mbështetjen dhe kontributin e grupeve të disiplinës për të lidhur deskriptotët e lëndës me ekspertizën e ligjëruesve në mënyrë që të përmirësojë cilësinë e procesit akademik.

Fakulteti gjithashtu është përqendruar edhe në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Me theks më të madh në procesin e monitorimit nëpërmjet takimeve të sigurimit të cilësisë së bashku me përfaqësues të komunitetit lokal dhe organet studentore si një mekanizëm i rëndësishëm korrigjues për të kapërcyer dobësitë në procesin akademik dhe administrativ. Në mënyrë të ngjashme, komunikimi profesional dhe pjesëmarrja gjithëpërfshirëse në fakultet në ndërtimin e një vizioni është përmirësuar. Fakulteti ka ngarkuar CV-të dhe profilin e stafit në ueb faqen e Universitetit.

3.6 Qendra për eMësim (The eLearning Center)

Me zhvillimin e ri të Teknologjive të informimit e metodave mësimore si dhe me ndikimin e tyre në mësimdhënie dhe mësimnxënie, bëhet një domosdoshmëri pajisja e kuadrit mësimdhënës me aftësitë e nevojshme për t'u ballafaquar me këto risi dhe për t'i shfrytëzuar ato në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Së këndejmi, fokusi kryesor i Qendrës për eLearning gjatë vitit 2011 vazhdoi të jetë përkrahja e komunitetit të universitetit për të shfrytëzuar potencialin e teknologjive në përmirësimin e procesit mësimor. Një nga qëllimet kryesore të Qendrës për eLearning është promovimi i edukimit cilësor i përqendruar te studenti nëpërmjet zhvillimit dhe ofrimit të IT lëndëve cilësore për studentët.

Në të njëjtën kohë, me qëllim që të mundësohet zhvillimi efikas i mësimit online shpesh ofrohen trajnime praktike për kuadrin mësimdhënës të UEJL-së. Këto programe të trajnimit mbulojnë një spektër të gjerë temash duke filluar nga dizajnimi i strukturës mësimore të lëndëve online, ku pjesëmarrësve u prezantohen koncepte dhe mjete të ndryshme që ndihmojnë në procesin e dizajnit pedagogjik të lëndëve online duke vazhduar me zhvillimin e online përmbajtjeve të lëndës me anë të mjeteve të ndryshme si Camtasia studio, Adobe Connect etj. Përveç kësaj, Qendra ofron përkrahje dhe trajnim për LMS-Libri dhe veglat e tij me qëllim që t'u mundësohet mësimdhënësve t'i publikojnë online përmbajtjet e lëndëve të tyre. Në qershor

Qendrën e vizitoi një ekspert ndërkombëtar për zhvillimin e përmbajtjes së lëndëve dhe ofroi trajnime intensive dy javore për 20 anëtarë të stafit akademik. Rezultatet e këtij trajnimi do të përdoren në vitin 2011-2012, kur universiteti do të ofrojë online programe në këto lëmenj: shkenca kompjuterike – deridiplomike (FSHTB); informatik biznes-pasdiplomike (FSHTB dhe FBE); Mësimdhënia e gjuhës angleze – pasdiplomike (FGJJK). Me qëllim që të fillojë me përgatitjet për studimet online, këtë vit Qendra për eMësim e formoi Laboratorin për Mësim në Distancë. Për më tepër, stafi i Qendrës për eMësim ofron përkrahje teknike gjatë incizimit dhe redaktimit të materialeve mësimore.

3.7 Instituti i mjedisit dhe shëndetit

Përkushtimi i Universitetit për ndryshimet klimatike dhe ruajtjen e mjedisit udhëhiqet nga Instituti për mjedisin dhe shëndetin (Institute for Environment and Health), të cilit i është dhënë statusi i njësisë së veçantë akademike. Gjatë kësaj periudhe, Instituti për mjedisin dhe shëndetin ka pasur për qëllim të sigurojë aktivitetet organizative dhe të zhvillimit, kërkimin shkencor, të promovojë e të ngrisë vetëdijen dhe të rritë partneritetin për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit dhe shëndetit në nivel rajonal dhe global. Instituti është njësi ndërdisiplinore, i përbërë nga 10 anëtarë të stafit akademik, 5 bashkëpunëtorë të jashtëm- hulumtues, 30 studentë hulumtues dhe 3 anëtarë të stafit administrativ. Instituti është i pajisur mirë për studime në terren dhe ka pajisje të përshtatshme informatike. Kontributi i Institutit konsiston me progresin e çështjeve mjedisore dhe shëndetësore, sigurimin dhe zhvillimin e programeve studimore me literaturë adekuate, kushte të mira për aktivitete kërkimore - shkencore, për promovimin e mjedisit dhe të shëndetit nëpërmjet vetëdijësimit të publikut, duke siguruar që biblioteka të ketë literaturë të përhershme dhe rritjen e nivelit të ndikimit dhe të profesionalizmit përmes partneriteteve dhe korporatat me institucionet dhe organizatat rajonale dhe ndërkombëtare. Për herë të parë këtë vit, Instituti ka ofruar lëndë zgjedhore nga lëmi i mjedisit për të gjithë studentët e UEJL. Këtë vit këto nuk kishin kredi por Instituti planifikon të zhvillojë lëndë plotësuese për kredi.

3.8 Qendra e gjuhëve

Qendra e gjuhëve (LC) ka vazhduar me zbatimin e suksesshëm të programeve akademike dhe zhvillimin e testeve kontrolluese në të tri gjuhët: anglisht, shqip dhe maqedonisht duke u përqendruar posaçërisht në shkathtësitë komunikuese të studentëve. Kjo u arrit me pilotimin e një provimi me gojë në anglisht dhe organizimin e provimeve për njohjen e gjuhës maqedonase dhe shqipe. Progresi në zbatimin e rekomandimeve nga raporti i vlerësimit të jashtëm nga viti 2010 vazhdoi – ku numri i studentëve, ose klasa, është zvogëluar, orët mësimore janë ndarë për të shmangur mësimdhënien në blloqe për nivelet fillestare. Poashtu janë bërë disa përpjekje për të përmirësuar kurrikulat dhe kompetencat e mësimdhënësve të gjuhëve lokale.

Qendra ka dhënë mbështetje të fuqishme për zhvillimin profesional individual, si dhe trajnimi i stafit ka rezultuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Pjesëmarrja e të gjithë mësimdhënësve në punëtori për metodologjinë dhe programin e certifikatës të mbajtur nga studiues Fulbright ishte e shkëlqyeshme. Vëzhgimi i mësimdhënies dhe vlerësimi nga studentët gjithashtu tregoj përmirësimin pozitiv të cilësisë në mësimdhënie dhe kënaqësisë së studentëve. Pjesëmarrja e lartë e studentëve në orët mësimore të gjuhëve është një tregues i rëndësishëm i kënaqësisë studentëve me lëndët që ofrohen nga QGJ.

Themelimi i US Alumni tryezës mbështetëse për studentët që aplikojnë për bursa studimore për në ShBA, klubet e sportit dhe të fotos, të nxitura nga LC-ja, kanë potencial për ta shndërruar atë në një qendër të jetës studentore në UEJL. Janë bërë gjithashtu përpjekje të caktuara për të diversifikuar të ardhurat e pavarura nga ana e LC-së. Kursi përgatitor për TOEFL u përfundua nga 18 kandidatë. Një tjetër CELTA kurs u mbajt në qershor ashtu si dhe një kurs intensiv në gjuhën shqipe për studentë e huaj.

4.0 Sigurimi i cilësisë

Bordi i universitetit ka mbajtur fokusin strategjik dhe qeverisës përmes monitorimit të rregullt të planeve të universitetit dhe përdorimit efektiv të cilësisë së të dhënave në lidhje me fusha të tilla si qëndrueshmëria financiare, stafi e menaxhimi i performancës, si dhe zhvillimi akademik. Punë të detajuara janë kryer nga Komiteti për çështje të stafit (Staffing Committee) dhe Komiteti për auditim dhe menaxhim të rrezikut (Audit and Risk Management Committee). Komiteti për çështje të stafit ishte veçanërisht i kënaqur të konstatojë se rregulloret kryesore të universitetit janë rishikuar (me konsultim të gjerë dhe me miratim përfundimtar nga Senati ose Bordi), një doracak për burimet njerëzore është përgatitur për përdorim të përgjithshëm nga stafi. Raporti vjetor për rekrutim vë në dukje se vendet e lira administrative janë plotësuar duke ndjekur një proces të rreptë, të hapur dhe transparent. Rregullorja për rangim, rroga dhe kompensime të tjera është implementuar. Njëherësh edhe faza e rishikimit dhe e ankesave është kompletuar. Kjo përfaqëson një ndryshim drejt një sistemi të shpërblimit më të rregulluar në bazë të ngarkesës së punës dhe të lidhur në mënyrë eksplicite me përshkrimin e vendit të punës. Një përmirësim i rëndësishëm ishte zbatimi i një sistemi të vlerësimit më aktiv të bazuar në prova dhe që rezulton në objektivat e miratuara për vitin e ardhshëm. Kishte ndjekje të veprimit nga drejtuesit e lartë, ashtu siç kërkohet. Komiteti për auditim dhe menaxhim të rrezikut ka zhvilluar konceptin dhe përdorimin e vlerësimit të rrezikut dhe mori një cilësi më të lartë të raporteve financiare në të cilat si bazë shërbejnë rekomandimet e tij. Bordi ka anketuar anëtarët e vet për efektivitetin e punës dhe kontributin e tyre dhe planet për të përdorur mundësinë e rinovimit të anëtarësimit për forcimin e kriterëve të emërimit.

Vitin e kaluar, ekipi i menaxherial i rektorit paraqiti planet e veprimit për zonat e tyre të përgjegjësisë në një takim të përgjithshëm me stafin. Këto të dhëna paraqitën një pasqyrë të drejtimit dhe zhvillimeve planifikuar, pastaj mbështetën fakultetet/qendrat dhe departamentet në përgatitjen planeve të veprimit

të tyre të cilat u moderuan dhe u monitoruan. Për herë të parë, fakultetet dhe qendrat përgatitën planet strategjike afatmesme, veçanërisht të rëndësishme për zhvillimin e kurrikulave dhe për planifikimin e burimeve njerëzore. Fakultetet/qendrat, në bashkëpunim me provostin dhe prorektorin për ndërmarrësi dhe zhvillim ishin në gjendje të implementojnë një cikël të planifikimit në një mënyrë më të kujdesshme dhe të menduarit përpara. Këshilli i rektorit ka ruajtur rolin e tij si një organ për diskutim, qarkullimin të informacionit dhe këshillave.

Struktura menaxheriale e fakulteteve u rikonfirmua dhe përbëhet nga dekanë dhe dy prodekanë (një për ciklin e parë dhe për ciklin e dytë të studimeve). Në nëntor të vitit 2010, u emëruan dekanët e rinj. Dekanët janë zgjedhur duke marrë parasysh vlerësimet e këshillave të fakulteteve, intervistës dhe rekomandimeve nga rektori dhe miratimin nga Bordi. Prodekanët janë zgjedhur nga dekanët. Kjo krijoi disa vonesa në proceset e fakulteteve të tilla si prodhimi planeve të veprimit dhe trajnimit, por njëherësh paraqiste potencial për zhvillimet dhe drejtimit e reja. Gjatë vitit, katër fakultete gjithashtu iu nënshtruan vlerësimit të jashtëm, të udhëhequr nga ekspertë ndërkombëtarë në fushën përkatëse. Ky cikël ka përfunduar me sukses për çdo fakultet dhe ka dhënë udhëzime largpamëse dhe të thella për fakultetet. Është planifikuar që ky cikël të përsëritet çdo katër ose deri në gjashtë vjet.

Sekretari i përgjithshëm mbeti përgjegjës për menaxhimin e cilësisë administrative. Nuk ka pasur ndryshime në strukturën e departamentit ose cilësinë, përveç se Departamenti i ri për informim dhe promovim iu bashkua ekipit qendror administrativ të cilësisë, të mbikëqyruar nga Këshilltari i rektorit për PR dhe komunikim. Planveprimet e departamenteve u moderuan, u zbatuan dhe u monitoruan rregullisht. Universiteti ishte përsëri i suksesshëm në arritjen e standardeve ISO.

Në lidhje me strukturën e sigurimit të cilësisë, duhet theksuar se politika e cilësisë është e lidhur drejtpërsëdrejti me Planin strategjik të universitetit dhe Komisionin për sigurimin dhe menaxhimin e cilësisë (KSMC) dhe kjo vazhdoi me rolin për monitorimin dhe llogaridhënien sa i përket funksionimit efektiv dhe të bashkëpunimit të frytshëm në mes ekipeve akademike dhe administrative të cilësisë. Zyra për sigurimin e cilësisë ka shërbyer si koordinator i aktiviteteve operative. “Kampioni i cilësisë” i jashtëm është fokusuar në çështjet e hulumtimit si sigurimi i komenteve të përgjithshme të cilat duhet të merren në konsideratë.

Ende ka nevojë për t’u bërë më shumë punë në nivel të fakultetit për zhvillimin e iniciativave autonome të cilësisë dhe për pranimin e punës së ekipeve të cilësisë në mënyrë aktive dhe efektive. Një fokus i vazhdueshëm për ndërlidhje efikase dhe bashkëpunim ndërmjet njësive akademike dhe administrative është nevojshëm, si të ishte komunikim brendshëm.

5.0 Mësimdhënia dhe nxënia

5.1 Programet dhe statusi

UEJL ka ofruar trembëdhjetë programe studimore unike në ciklin e parë dhe njëzet e tre programe të veçanta në ciklin e dytë gjatë periodës midis viteve 2010-2011, në njërin nga tri gjuhët zyrtare që përdoren në universitet - shqip, maqedonisht dhe anglisht. Programet “popullore” janë ofruar në dy gjuhë lokale dhe disa programe të reja, në rajon, janë ofruar vetëm në anglisht. Përveç kësaj, studentëve u ofrohet mundësia të studiojnë me status të rregullt ose me korrespondencë.

Programet e ciklit të dytë vazhduan të paraqesin sfida për universitetin. Zyra e planifikimit akademik për studimet e ciklit të dytë ka punuar me provostin për të lehtësuar mentorimin e studentëve dhe procesin e përpilimit të tezës së magistraturës, procesin e miratimit të tezës dhe mbrojtjes. Studentëve u është ofruar mbështetje shtesë për shkrim të tezës në klasa të vogla të udhëhequra nga anëtarë seniorë të stafit akademik. Numri i studentëve të diplomuar në programet e ciklit të dytë është rritur ndjeshëm si rezultat i përpjekjeve të tilla.

Studentët në studimet me korrespondencë në ciklin e parë përsëri formuan një grup të rëndësishëm. Shumë nga studentët me korrespondencë janë duke punuar -profesionistë ose nga ata që mësojnë gjatë tërë jetës. Universiteti ka përsosur sistemin për menaxhimin e lëndës (LIBRI) si një burim shtesë për të plotësuar nevojat e këtyre studentëve. Përveç kësaj, stafi akademik ka zgjedhur për t'u takuar më shpesh me studentët me korrespondencë.

5.2 Regjistrimi i studentëve


Gjatë kësaj periudhe jemi dëshmitarë të një rënieje të caktuar të numrit të përgjithshëm të studentëve që regjistrohen në UEJL në të dy ciklet dhe në të dy regjimet e studimit të rregullt dhe me korrespondencë. Këto numra pasqyrojnë gjendjen e vështirtë të vazhdueshme në mbarë botën ekonomike. Por edhe rënia e regjistrimeve në institucionet tjera jo-publike është në proporcion të anasjelltë të regjistrimeve në institucionet shtetërore. Pasi UEJL në mënyrë kritike varet nga numri i regjistrimeve të studentëve si një nga burimet kryesore për financimin e operacioneve, rënia shkaktoi diskutim të gjerë në universitet dhe në nivel fakultetit. Një anë pozitive, për rënien e numrit të studentëve është se ata marrin shërbime më të mira, ku gjithashtu i numri i studentëve në grupe është më i vogël. Tabelat dhe gafikonët në vazhdim paraqesin numrin e studentëve të regjistruar (në ciklin e parë-të rregullt dhe me korrespondencë dhe ciklin e dytë), për tri vitet e fundit akademik. Gjithashtu, vihet re se numri i përgjithshëm i studentëve që studiojnë në programet që ofrohen në gjuhën angleze është rritur çdo vit. Administrata e UEJL-së dhe stafi

akademik kanë analizuar numrat në rënie të studentëve në mjedise të shumta dhe janë duke zhvilluar strategji të reja largpamëse për të menaxhuar këtë zhvillim.

Viti	Regjistrimet
2008/2009	1794
2009/2010	1889
2010/2011	1595
Gjithsejtë	5278

Tabela 5.20 Numri i përgjithshëm sipas viteve akademike

Grafikoni 5.21 tregon uljen e numrit të regjistrimeve sipas gjuhës së studimit. Programet studimore që ofrohen në shqip dhe maqedonisht krahasuar me vitin akademik 2009/2010 në 2010/2011 ka ulje, por, në mënyrë të konsiderueshme, programet që ofrohen në gjuhën angleze në të vërtetë shënojnë rritje gjatë kësaj periudhe të njëjtë. Kjo mund të shpjegohet me faktin se programet që ofrohen në gjuhën angleze (në ciklin e 1 dhe 2) informatika e biznesit, sistemet e informacionit dhe menaxhmenti, gjuhë angleze dhe letërsi (në ciklin e 1-rë dhe 2-të) janë të mirëmenaxhuara, atraktive për tregun lokal dhe me staf energjik, të rinj, profesionistë me diplomë të klasit të parë. Qëllimet e arsimit të integruar janë plotësuar edhe në programe të tilla studentët shqiptarë ulen krah për krah me ato maqedonas dhe gjithnjë është në rritje numri i studentëve nga jashtë rajonit me asnjë njohuri për gjuhën shqipe ose maqedonase.



Grafikoni 5.21 Regjistrimet e përgjithshme (cikli i 1+ cikli i 2)

Shifrat e përgjithshme për regjistrimet e analizuara nga fakultetet vënë në dukje ulje relative në pesë fakultetet. Fakultetet vetë dhe universiteti në tërësi kanë analizuar rëniet e ndryshme të numrit të studentëve.

Fakulteti	2008/2009	2009/2010	2010/2011	Total
BE	392	393	364	1149
SHTB	294	294	235	823
Juridik	360	356	320	1036
GJKK	240	314	301	855
APSHP	508	532	375	1415
Gjithsejtë	1794	1889	1595	5278

Tabela 5.21 Numrat për regjistrimet e përgjithshme nëpër fakultete

Nëse të dhënat e regjistrimit analizohen edhe më tej, sipas programeve brenda fakultetit dhe sipas cikleve, atëherë është e qartë se disa programe në të vërtetë janë bërë shumë popullore gjatë këtij viti të fundit. Kjo në të vërtetë është për t'u habitur duke pasur parasysh rënien e regjistrimeve, kurse e kundërta është me këto programe të veçanta të cilat meritojnë lëvdata. E njëjta gjë vlen për programet ku gjuha e studimit, është gjuha angleze, të cilat ndjekin trendet botërore dhe në të vërtetë janë duke u bërë gjithnjë e më popullore. Nuk duhet mohuar fakti se këto programe janë të një cilësie të lartë. Këto programe janë: financa dhe kontabilitet -120 kredi, cikli i dytë (FBE); menaxhment -120 kredi, cikli i dytë (FBE); informatika e biznesit, cikli i parë (SHTB); zhvilli i softuerit dhe aplikacioneve -120 cikli i dytë (SHTB); studimet për siguri -120 kredi (juridik);komunikim cikli i parë (GJKK); gjuhë dhe letërsi shqipe, cikli i parë dhe i dytë (GJKK); diplomaci -120 kredi (APSHP); shkenca politik,e cikli i dytë -120 kredi (APSHP); administrim publik, cikli i dytë -120 kredi (APSHP)).

5.3 Shkalla e kalueshmërisë

Shkalla e kalueshmërisë për qëllime të këtij raporti është kuptuar si një mjet për matjen progresit të studentëve në programin të tyre të studimit prej viti në vit. Duke ndjekur praktikën "jugosllave", UEJL përdor kreditë e akumuluar për të përcaktuar vitin në të cilin studenti i takon, duke çuar në një situatë ku studentët duhet të grumbullojnë ECTS në mënyrë që të arrijë statusin dhe privilegjet e që i përkasin vitit të ardhshëm. Kjo ka një ndikim të drejtpërdrejtë në vlerësimin e studentëve dhe çon në praktikën e mbajtjes së vazhdueshme të më shumë "sesioneve të provimit" për t'u lejuar studentëve më shumë mundësi për "të

kaluar provimet" duke mbledhur kreditë e kërkuara. Studentët të cilët "nuk" kanë progres duhet të paguajë një tarifë dhe të "presin" për provimet tjera gjatë "sesioneve të provimeve". Mbajtja llogari për një përparim të tillë ashtu si në aspektin akademik dhe financiar krijon tendosje të madhe në administratën e universitetit. Një përkufizim i tillë i mbajtjes llogari është i vjetruar dhe duhet të zëvendësohet me një model më të dobishëm duke matur përqindjen e studentëve që diplomojnë në kohë, pra brenda tre viteve në një program me 180 ECTS. Kushtet për kalueshmëri nuk janë të zbatueshme për studentët me korrespondencë ose studimet në distance. Për këtë arsye ata nuk janë përfshirë këtu. Në tabelat e mëposhtme janë të dhënat për kalueshmërinë e studentëve nga viti 1-rë në të 2-tin dhe nga i 2-ti në të 3-tin, të shpërndarë për fakultete. Për gjeneratën e vitit 2008/09, ka një ngritje të lehtë të kalueshmërisë 68% në vitin e tretë. Në vitin e dytë kjo gjeneratë ka pasur shkallë më të mirë të kalueshmërisë 81%, ku F. juridik ka shkallën më të ulët, ndërsa fakultet tjera janë rreth mesatares së universitetit për këtë gjeneratë.

Gjenerata	Regjistrimet	Kalueshmëria		Kalueshmëria	
2008/09	2008/09	2009/10		2010/11	
Fakultetet	Studentë	Kalueshmëria	%	Kalueshmëria	%
		Në vitin 2		Në vitin 3	
BE	251	207	82%	168	67%
SHTB	217	169	78%	140	65%
Juridik	227	185	81%	142	63%
APSHP	309	251	81%	220	71%
GJKK	162	136	84%	118	73%
Gjithsejtë	1166	948	81%	788	68%

Tabela 5.30 Kalueshmëria për gjeneratën 2008/09

Në tabelën në vazhdim është dhënë shkalla e kalueshmërisë për gjeneratën 2009/10 e cila është 73% në nivel të Universitetit.

Gjenerata 2009/10	Regjistrimet në studimet rregullta 2009/10	Kalueshmëria 2010/11		Kalueshmëria 2011/12	
		Kalueshmëria	%	Kalueshmëria	Fakultetet
Fakultetet	Studentë	Në vitin 2		Në vitin 3	
BE	199	160	80%	143	72%
SHTB	207	174	84%	140	70%
Juridik	186	164	88%	129	72%
APSHP	312	268	86%	237	77%
GJKK	164	133	81%	111	69%
Gjithsejtë	1068	899	84%	732	73%

Tabela 5.31 Kalueshmëria për gjeneratën 2009/10

Në gjeneratën 2010/11 ka 893 studentë të rregullt ku për herë të parë shkalla e kalueshmërisë është 83% në vitin e 2 të studimit. Në tabelën në vazhdim mund të shohim se fakulteti i GJKK ka shkallën më të lartë të kalueshmërisë nga fakultetet tjera, ku FAPSHP ka shkallën më të ulët 79%. Aktualisht kjo gjeneratë është në vitin e dytë.


Gjenerata 2010/11	Regjistrimet në studimet e rregullta	Kalueshmëria 2011/12	
	2010/11		
Fakultetet	Studentë	Kalueshmëria Në vitin 2	%
BE	173	149	86%
SHTB	165	133	81%
Juridik	185	154	83%
GJKK	171	150	88%
APSHP	199	158	79%
Gjithsejtë	893	744	83%

Tabela 5.32 Kalueshmëria për gjeneratën 2010/11

5.4 Shkalla e diplomimit

Një masë e rëndësishme për matjen e suksesit të një studenti të veçantë dhe të universitetit është nëse studenti komplet programin e tij në kohë, ose diplomon në kohën e dhënë për akumulimin e kredive dhe njohurive. UEJL ndjek arritjet e studentëve të rregullt dhe në këtë pjesë është dhënë shkalla e diplomimit për gjeneratën 2008/09. Nga gjenerata 2008/2009 vetëm 23% e studentëve kanë diplomuar në kohë, kurse 64% ende nuk kanë diplomuar (kanë reregjistruar lëndët që nuk i kanë kaluar) dhe 15% janë joaktivë ose janë tërhequr. Krahasuar me gjeneratën e mëparshme 2007/08, kjo gjeneratë ka përqindjen më të ulët të studentëve që diplomojnë në kohë e cila është 9% më e ulët se gjenerata paraprake (32% kanë diplomuar në kohë). Vini re, se në gjeneratën e paraprake të diplomuar në kohë janë llogaritur edhe studentët që kanë diplomuar në sesionin e nëntorit, kurse për këtë gjeneratë të diplomuar në kohë janë llogaritur vetëm ata që kanë diplomuar deri në sesionin e gushtit.

Përsa i përket diplomimit në kohë të shpërndarë në fakultete, grafikoni i mëposhtëm ilustron se diplomimi në kohë është më i ulët në fakultetin SHTB me vetëm 16%, F. juridik dhe FBE me 18% gjegjësisht 19%, kurse FGJKK ka shkallën më të lartë me 35%, ndërsa APSHP ka shkallën prej 27%..



Grafikoni 5.40 shkalla diplomimit nëpër fakultete për gjeneratën 2008/2009

Nëse analizojmë shkallën e diplomimit për studimet e ciklit 2, situata është pak më ndryshe. Vetëm pak studentë diplomojnë "në kohë", por definicioni "në kohë" për programet profesionale master duhet të rikonsiderohet. UEJL mund të eksplorojnë për të ofruar me programe master me korrespondencë ku studentët do të jenë në gjendje të përparojë me një ritëm të ngadaltë, duke i ndihmuar ata studentë që kanë angazhime profesionale.

Sipas të dhënave për numrin e studentëve që kanë mbaruar ciklin e dytë në UEJL, është e qartë se vetëm 9,7% (205 studentë) nga numri i përgjithshëm i studentëve në ciklin e 2-të kanë diplomuar. Numri më i madh i të diplomuarve është në fakultetin e APSHP ku 113 ose 55% e studentëve kanë mbaruar nga numri i përgjithshëm i tyre. Në Fakultetin e GJKK kanë diplomuar 50 studentë ose 24% nga numri i përgjithshëm. Në FSHTB vetëm 15 studentë kanë diplomuar ose 7% nga numri i përgjithshëm. Në FBE vetëm 13 studentë kanë diplomuar ose 6% nga numri i përgjithshëm, ndërsa deri më 30 gusht 2011 në F. Juridik vetëm 4 studentë kanë diplomuar ose 2% nga numri i përgjithshëm. Menaxhmenti i universitetit dhe fakultetit kanë iniciuar programe për mbështetje të studentëve në janar 2011, me qëllim të rritjes së shkallës së diplomimit për studentët e ciklit të dytë. Tashmë nga fundi i vitit, këto programe janë duke dhënë efektin dhe shkalla e diplomimit për këtë grup vazhdon të rritet.

5.6 Vlerësimi nga studentët

Nga janari 2011, procesi i vitit të kaluar është rishikuar dhe kjo punë rezultoi me disa ndryshime në ISO procedura. U vendos që të ngelin të njëjta pyetjet dhe proceset për stafin akademik, kurse të rishikohen pyetjet për pjesën administrative dhe i gjithë procesi të implementohet në formë elektronike. Gjithashtu në dhjetor 2010, provosti, në bashkëpunim me stafin nga Fakulteti i SHTB, e realizoi një pilot projekt për vlerësim të lëndëve duke përdorur pyetësoin e përshtatur on-line. Në qershor 2011, provosti koordinoi

procesin edhe më tej duke përdorur pilot aplikacionin on-line nëpërmjet Libri-t. Këto anketime janë paraparë të jenë për mësimdhënës individualë dhe të përdoren për zhvillimin e tyre në vend se të përdoren për vlerësim formal dhe për menaxhim të performancës.


Procesi i vlerësimit akademik është planifikuar dhe është realizuar gjatë një muaji - prill, dy javët e para për studentët në studimet deridiplomike dhe javët e fundit për studentët në studimet pasdiplomike. Si zakonisht, kjo është koordinuar nga Zyra e cilësisë, Shërbimi për studentë dhe këshilltarët studentorë.

Rezultatet nga vlerësimi i studentëve për stafin akademik u proceduan nga Shërbimi për studentë and confidential, raportet individuale në konfidencë janë dërguar anëtarëve të stafit, ekipit ekzekutiv, ZBNJ-së dhe dekanëve/drejtorëve. Dekanët/drejtorët përdorën këto raporte në takimin e vlerësimit me stafin.


Vlerësimi i proceseve administrative ka filluar më herët, në muajin prill. Sistemi u mbajt i hapur për disa javë për të inkurajuar pjesëmarrjen, veçanërisht për arsye se një numër i pjesëmarrësve nuk kishte qasje në llogaritë si rezultat i mospagesës së shkollimit. Të gjithë anëtarët e stafit dhe studentët janë njoftuar me e-mail për procesin dhe gjithashtu është raportuar në Këshillin e rektorit. Duhet përmendur se nuk kishte të dhëna krahasuese nga viti i kaluar për arsye se disa pyetje ishin ndryshuar. Lidhur me procesin, përdorimin, vlerën dhe rezultatet janë bërë analiza në mënyrë të hollësishme nga udhëheqësit administrativë gjatë mbledhjeve të kolegjiut. Me këtë rast u kërkuan veprime përcjellëse me pika kryesore të përfshira në plan veprimet e vitit të ardhshëm.

Përmbledhje e raporteve të vlerësimit janë të përfshira këtu. Këto raporte janë qarkulluar për stafin dhe studentët dhe janë diskutuar gjerësisht.

Vlerësimi i stafit akademik nga ana e studentëve



Vlerësimi i administratës nga ana e studentëve



5.7 Qendra e karrierës

UEJL - Tetovë është shtëpia e Qendrës së karrierës e cila ofron këshilla dhe trajnim të plotë për karrierën dhe kërkim të vendeve të punës për studentët e universitetit. Qendra ofron këshillim individual dhe grupor në fusha të tilla si shkrim të CV-së, shkrim të letër interesit, teknikat e intervistimit, etj. Përveç kësaj, Qendra menaxhon stazhimin (internship) dhe punën praktike. Qendra gjithashtu organizon panairin e karrierës dhe është nikoqir i tij për çdo vit pune. E rëndësishme është se Qendra e karrierës raporton për aftësitë e të diplomuarave nga UEJL për të gjetur punë, si këtu në Maqedoni dhe jashtë vendit. Rezultatet nga kjo anketë janë siguruar nga anketimi i asociacionit të të diplomuarve (Alumni). Gjetjet kryesore nga ky raport tregojnë se studentët e UEJL vazhdojnë të jenë të punësuar në një shkallë më të lartë se mesatarja nga universitetet shtetërore.

Gjetjet nga anketimi i aluminit nga viti 2009 tregojnë se shkalla e punësimit në nivel të universitetit është 45,39% dhe shkalla e përgjithshme e papunësisë është 54,61%, por kur të marrim parasysh përqindjen e të papunëve ose që studiojnë me zgjedhje (7,61%) dhe studentët të cilët po vazhdojnë arsimimin e tyre (13,90%), shkalla e përgjithshme e papunësisë vlerësohet të jetë 33.1%.

Në nivelin të fakultetit, rezultatet e sondazhit tregojnë se normë më të lartë të papunësisë kanë të diplomuarit në fakultetin e APSHP 63.53% (ku 4.30% tregojnë se kjo është me zgjedhjen e tyre), të ndjekur nga të diplomuarit në Fakultetin juridik me 63.48% (ku 6.02% tregojnë se kjo është me zgjedhjen e tyre) dhe të diplomuarit në FBE 52.26% (ku 8.77% tregojnë se kjo është me zgjedhjen e tyre). Normat

më të ulëta të papunësisë janë dëshmuar në FSHTB 41.53% (ku 4.13% tregojnë se kjo është me zgjedhjen e tyre), të ndjekur nga FGJKK me 51.25% (ku 4.13% tregojnë se kjo është me zgjedhjen e tyre).

Kur të merret parasysh klasifikimi sipas variablave gjinore dhe përkatësisë etnike, rezultatet tregojnë se nuk ka ndryshim të madh në shkallën e papunësisë e të diplomuarve me prejardhje shqiptare dhe maqedonase. Të diplomuarit meshkuj (50%) kanë normë shumë më e ulët të papunësisë sesa diplomuarit femra (59.17%).

Sipas analizës multivariante, ekziston një marrëdhënie statistikisht e rëndësishme në mes variablave të statusit të punësimit dhe notës mesatare. Rezultatet tregojnë se të diplomuarit me notë mesatare midis 9 dhe 10 kanë një normë të papunësisë prej 52%, ndërsa të diplomuarit me notë mesatare midis 8 dhe 9 kanë një shkallë të papunësisë më të lartë deri 56,11%. Bazuar në rezultatet e anketës 30,02% e të diplomuarve të punësuar kanë gjetur punë në periudhën prej 10-12 muajsh; ndërsa 27.74% nga në periudhë 1-3 muajsh dhe 16.56% përpara se të diplomojnë. Përafërsisht 3,31% e të diplomuarve të punësuar kanë treguar 12 ose më shumë muaj ose se ata nuk e mban mend, se sa kohë u desh për të gjetur punë.

Sipas nivelit të sektorit, të dhënat e mëposhtme tregojnë se sektori publik është më i përfaqësuar në sondazhin e këtij viti me 58,79%, por sektori privat ende mbetet punëdhënësi më përfaqësuar për të diplomuarit në UEJL me 39,33% të numrit të përgjithshëm të të diplomuarve të punësuar, në krahasim nga studimi vitit të kaluar nga të cilat ne kemi ndryshime të rëndësishme nga sektori privat në sektorin publik. Ky trend është dëshmuar edhe në analizën në nivel të industrisë, ku qeveria (23,18%) dhe arsimi (21,94%) deri tani janë punëdhënësit më të mëdhenj të diplomuarve nga UEJL me 45,12%, e ndjekur nga tregtia (16,97%) dhe shërbimet me 13,66%. Sektori bankar është përfaqësuar këtë vit me 5,79%. Kategoria "të tjera" përfshin ndërmarrjet private, ku ka qenë e vështirë për të përcaktuar fushën e tyre të veprimit për shkak të mungesës së përgjigjeve dhe fushat e operacioneve që kanë treguar të jenë përafërsisht 6.21%.

Sipas madhësisë qytetit dhe kompanisë, shumica dërrmuese e të diplomuarve kanë gjetur punë në Shkup dhe Tetovë në kuadër të firmave të vogla (10-49 punonjës) dhe firmave të mesme (50-249 punonjës). 84,67% e të diplomuarve kanë gjetur punë në Maqedoni, Kosovë 8,69%, 1,24% në SHBA dhe 5,38% në vendet e tjera. 42,05% e të diplomuarve kanë gjetur punë në Shkup, 35,20% në Tetovë, 10,75% në Gostivar dhe të tjerët në qytete të tjera të Maqedonisë.

Në lidhje me shkallën se sa po ndjekin studimet e ciklit të dytë të diplomuarit, rezultatet tregojnë se vetëm 36,18% e të diplomuarve ndjekin studimet e ciklit të dytë i cili është pak më i lartë se 31,19% e të intervistuarve të vitit të mëparshëm. Shumica e të diplomuarve ndjekin studimet e ciklit të dytë 71,16% në UEJL, ndërsa 9,87% janë duke ndjekur studimet e ciklit të dytë në Universitetin shtetëror të Shkupit (UKIM) dhe 3.37% janë duke ndjekur studimet e ciklit të dytë në Universitetin shtetëror të Tetovës.

Së fundi, pyetja e fundit e parashtruar studentëve në lidhje me programin e tyre të studimit, se sa i ka përgatitur ata programi për tregun e punës. Këto varibala janë matur në shkallë të pesë pikëve (1 = shumë pak dhe 5 shumë). 32,80% e studentëve janë përgjigjur se programi studimor i fakultetit i ka përgatitur ata për tregun e punës dhe më pak se 1% janë përgjigjur se programi studimor nuk i ka përgatitur ata për tregun e punës.

5.8 Asociacioni Alumni

UEJL ka Asociacionin Alumni (ish të diplomuarit) plotësisht funksional me seli në kampusin në Tetovë. Asociacioni Alumni është i hapur për të gjithë të diplomuarit e UEJL-së dhe është organizator i një numri të rrjeteve dhe ngjarjeve vjetore. Asociacioni Alumni bashkëpunon ngushtë me Qendrën karrierës për të siguruar që të gjithë të diplomuarit e UEJL të keni mbështetje gjatë karrierën e tyre profesionale.

6.0 Hulumtimi

Gjatë kësaj periode kohore Zyra për hulumtim (ZH), është e mbikëqyrur nga Blerim Reka, prorektor për hulumtime. Zyra vazhdoi të përqendrohet në sigurimin e mbështetjes për iniciativa për hulumtim të stafit akademik të UEJL-së. Detyra e parë ishte për të zhvilluar një strategji tre vjeçare për hulumtim 2010-2014, ku struktura dhe organizimi i hulumtimit, plani i veprimit, udhëzimet për hulumtim, tabelat e implementimit të planit të veprimit për hulumtim dhe raportet për implementimin e projekteve ndërkombëtare janë të detajuara. E rëndësishme është se komponenta e hulumtimit u bë pjesë e dosjes akademike, e cila është e lidhur me promovimin dhe punësimin.

U identifikuan dhe emëruan drejtorët e qendrave hulumtuese për secilin fakultet veçmas. Zyra ka zhvilluar databazën online për hulumtim (<https://aspes.seeu.edu.mk/Account/Login.aspx>). Të dhënat për hulumtim për shumicën e stafit akademik të UEJL janë ngarkuar në këtë sistem. Stafi i UEJL ka botuar 22 artikuj kërkimorë në revista ndërkombëtare, të mbështetur nga vija buxhetore për hulumtim dhe zhvillim R & D. Katërmbëdhjetë tekste universitare janë botuar dhe janë menaxhuar nga Zyra për hulumtim. Planet janë bërë për të krijuar një çmim për hulumtuesin/studiuuesin e vitit, si një mjet për të motivuar stafin e interesuar për hulumtim dhe përsosmëri në këtë fushë. Në qershor 2011, Universiteti vendosi për të përmirësuar strukturën e qendrave hulumtuese dhe krijoi dy institute të reja hulumtuese me një shtrirje më të gjerë se në një fakultet i vetëm, në vend të pesë qendrave ekzistuese në fakultetet përkatëse. Këto institute të reja hulumtuese janë parashikuar të fillojnë të funksionojnë në 2011-2012.

Nga tetori i 2010-tës deri në fund të majit të vitit 2011, ZH, së bashku me drejtorin për studime të doktoratës dhe dekanët e fakulteteve, ka punuar në rregulloren e universitetit për hulumtime shkencore dhe studimet e ciklit të tretë. Së bashku me rregulloret tjera përkatëse, politikat dhe proceset, zyra ka krijuar një mjet të qartë për të matur objektivist hulumtimin në nivel të fakultetit. Kurse sa i përket programit të doktoratës, UEJL ka vendosur të vazhdojë me sistemin e ashtuquajtur mentorial dhe ku janë zhvilluar kriteret e si për pranimin e studentëve dhe caktimin e mentorëve. Deri më 30 studentë janë planifikuar për t'u pranuar në këtë program.

Gjatë vitit, UEJL filloi bashkëpunimin me universitetet evropiane në tri projekte të reja TEMPUS dhe ishte i përfshirë në mënyrë aktive në dhjetë projekte tjera që filluan në vitin 2009 dhe janë planifikuar të përfundojnë në vitin 2012. Një program nga *Regional Research Promotional Program (RRPP)* ishte aktiv gjatë kësaj periudhe si dhe projekt UNDP dhe një projekt nga programi FP7. Zyra udhëhoqi zhvillimin dhe mbajtjen e një konference të madhe në përvjetorin e dhjetë të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (MKO) dhe më 20-21 qershor 2011 një konferencë ndërkombëtare është organizuar në UEJL-Tetovë dhe UKIM-Shkup. Projekti ka tërhequr mbështetjen dhe njohjen kombëtare dhe ndërkombëtare.

Një seminar për studimet e doktoratës dhe një seri seminaresh në përgatitjen e projektpropozimeve për FP7 janë koordinuar nga zyra, të udhëhequr nga stafi ekspert i zyrës. Kërkesa e parë për Programin Zhan Mone ishte përgatitur dhe ishte dërguar në BE. Zyra ka punuar nga afër me fakultetet për të zhvilluar një procedurë për kërkimin e motivimit individual në UEJL. Zyra ka drejtuar revistën shkencore *SEEU Review* dhe gjatë kësaj periudhe, janë botuar dy vëllime në logon e hulumtimit. Janë botuar dhjetë tekste universitare ku autor kanë stafin akademik të universitetit.

7.0 Ndërmarrësi dhe zhvillim

Universiteti filloi edhe me një tjetër risi në vitin 2010, kur emëroi Abdylmenaf Bexhetin në postin e prorektorit për ndërmarrësi dhe zhvillim. Në UEJL, qasja sipërmarrëse nuk ka për qëllim vetëm menaxhimin strategjik, por edhe vënien në lëvizje të të gjitha niveleve dhe strukturave të universitetit, për të frymëzuar dhe për të inkurajuar një mënyrë të re të zhvillimit. Anëtarët e stafit, me përkushtim, krijuan mundësi për qëndrueshmërinë afatgjatë të institucionit.

Në parimet e menaxhimit, universiteti është përkushtuar të krijojë një kulturë të përgjegjshme dhe të sjelljes në shpërndarjen dhe menaxhimin e të gjitha burimeve, në bazë të llogaridhënies ekonomike dhe financiare dhe të arsyeshmërisë. Çdo njësi operohet mbi bazën e arsyes ekonomike dhe financiare. Në këtë qasje, një strukturë bazuar në Treguesit e performancës kyçe (TPK) është krijuar dhe ofron mundësi për diferencimin individual të produktivitetit pavarësisht nga vështirësitë që kanë mbetur nga qasja "mekanike" në sistemin e vlerave në këtë institucion.

Subjektet e ndërmarrësisë u krijuan në strukturën institucionale, nga qendrat (Qendra për zhvillimin e biznesit) dhe institutet për ndërmarrësi komerciale të tilla si "Uni.com". Këto veprime mundësuan pjesëmarrjen e stafit akademik dhe administrativ në të gjitha nivelet, nga qasja individuale në institucionale, për të provuar kompetencën e tyre, profesionalizmin dhe motivimin për krijimin e vlerave financiare dhe materiale. Në kuadër të sistemeve të stimuluese (si Rregullorja për rroga dhe kompensime tjera, të ardhurat vetanake nga projekte të ndryshme, etj.), universitetit krijoi mundësi për ata që janë krijues dhe të përkushtuar. Kjo mbështetje institucionale mundëson këto struktura të hapin horizonte e mundësi të reja të financimit.

Në UEJL, gjatë vitit akademik 2010/11, janë realizuar disa projekte në bazë të shërbimeve tregtare të ofruara për kompani të ndryshme si në menaxhimin strategjik, analizën e tregut dhe rritjen e shitjeve, në pëpilimin e planeve të biznesit, dizajnimin e ueb faqeve për kompanitë, etj. Këto lloje të aktiviteteve u rritën gjatë vitit dhe motivuan angazhimin e departamenteve të tjera në universitet për një qasje të tillë. Të dhënat financiare gjatë vitit të kaluar akademik dëshmojnë një rritje prej 15% të të ardhurave nga këto shërbime dhe produkte. Teknologjitë ambicioze të informacionit në qendër të projektit dhe të projekteve të tjera nga qendra të tjera për shërbimin civil dhe institucional dhanë një drejtim tjetër për perspektivat sipërmarrëse të universitetit.

Në mënyrë domethënëse, kompanitë lokale dhe kombëtare dhanë mbi 20 bursa për studime në dy ciklet. Këta ishin hapat e parë drejt një strategjie të re që në këtë fushë u arritën, pavarësisht rrethanave sfiduese

makroekonomike dhe politike në vend. Përkushtimi për të vazhduar këtë qasje bën që Universiteti të jetë më i qëndrueshëm në peridat afatgjate.

8.0 Financat

Universiteti vazhdoi të jetë plotësisht i vetëfinancuar dhe varet nga pagesa e shkollimit të studentëve për pjesën më të madhe të të hyrave. Pavarësisht kontributit të fuqishëm të UEJL-t në buxhetin dhe ekonominë e Republikës së Maqedonisë (taksat e paguara për pagat, pajisjet, etj) dhe natyrën publike të disa prej fakulteteve të tij, UEJL nuk ka marrë fonde nga buxheti shtetëror. Zhvillimi i rrjedhave të reja të të ardhurave ishte një sistem që gjerësisht mori prioritet gjatë kësaj kohe. Nga fakultetet, departamentet dhe njësitë e tjera u kërkua të hartohen plane për të rritur të ardhurat e tyre. Proporcioni i të hyrave për vitin akademik/fiskal 2010/11 është si vijon: të ardhurat nga tarifat e shkollimit 85.41%, të ardhurat komerciale 5.27%, të ardhura tjera (interesi nga investimet, investimi në tregun e kapitalit (*endowment*), etj.), 2.62%, projektet dhe donacionet 6.7%. Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare mbetet një prioritet i strategjisë zhvillimore të Universitetit të Evropës Juglindore. Për më tepër, universiteti ka kërkuar burime shtesë të të ardhurave dhe duke e bërë këtë, pra, ka diversifikuar të ardhurat që kërkohen për të ulur përqindjen e varësisë midis burimeve të ndryshme të të ardhurave. Diversifikimi i portofolios të të ardhurave ka vazhduar me investimet në tregjet e kapitalit nëpërmjet një fondi investimi.

Aktivitetet kryesore për menaxhimin financiar në vitin akademik/fiskal 2010/11 ishin zhvillimi i vazhdueshëm i platformave ekzistuese softuerike. Qëllimi ishte të transferohet sistemi ekzistues financiar në sistemin Enterprise Resource Planning (ERP), gjë që do të rrisë informacionin e përgjithshëm të sistemit të menaxhimit të UEJL-së, të japë fitbek dhe të zhvillojë komunikim në mes të departamenteve dhe zyrave të ndryshme brenda sistemit. Sistemi u instalua, por në fund të vitit, ende ishte në fazën e testimit.

Një tjetër arritje e rëndësishme gjatë këtij viti ishte përpilimi i një set politikash dhe procedurash financiare të cilat kanë kontribuar në forcimin e kontrollit të brendshëm "ex- ante". Udhëheqësit e njësive dhe stafi profesional ishin të angazhuar në grupe të voglapër të analizuar, për të ndryshuar, në disa raste edhe për të rishkruar rregulloret, politikat dhe procedurat. Funksionimi i kontrollit financiar "ex-ante" dhe "ex-post" - me shërbimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm është zhvilluar më tej në mënyrë paralele me planifikim financiar.

Fakultetet/departamentet dhe qendrat vazhduan të marrin pjesë në mënyrë aktive në kornizën afatmesme të buxhetit. Megjithatë raportet tregojnë se realizimi i buxhetit të deleguar është në disproporcion dhe se ka nevojë për mbështetje dhe trajnim të mëtejshëm, veçanërisht si pjesë e procedurave të integruara.

9.0 Mjedisi në kampus dhe shërbimet

9.1 Përkrahja e studentëve

Përkrahja e studentëve bëhet kryesisht nëpërmjet Shërbimit për studentë, Zyrës për ndihma financiare. Studentët për vitin akademik 2010/2011 u përkrahën me programet e bursave të universitetit, bursave nga donatorët, me programin "Punë dhe studim" si dhe me lehtësim financiar për studentin e dytë dhe të tretë të familjes që financiarisht janë mbështetur gjithsej rreth 23% e numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt.

Programi i bursave përbëhet nga dy shtylla - programi i bursave meritore të universitetit, që për bazë ka parimin e meritës, rezultatet e treguara në testin për vlerësimin e dijeve paraprake dhe programi i bursave sipas nevojës financiare, në bashkëpunim me Institutin Shoqëri e hapur (SOROS) dhe Ambasadën e Mbretërisë së Holandës. Në nivel të universitetit u akorduan 341 bursa, nga të cilat 132 meritore dhe 209 ata të nevojës financiare, që do të thotë se afro 12% e numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt u përkrahën me bursa të cilët mbulojnë mbi 80 % të çmimit të kushtimit të studimeve në drejtimin përkatës.

Nga aspekti financiar, rreth 5% e studentëve të rregullt janë përkrahur edhe nëpërmjet programit "Punë dhe studim". Nëpërmjet këtij programi studentët angazhohen në shërbime të ndryshme të universitetit duke përfutur eksperiencën përkatëse si dhe realizojnë edhe mjete financiare për të mbuluar një pjesë të studimeve. Në këtë vit akademik u përfshinë 125 studentë në këtë program.

Gjithashtu, në mbështetjen e familjeve që në UEJL kanë dy apo më tepër studentë, është akorduar lehtësim në pagesë për shkollim për studentin e dytë apo të tretë të familjes në vlerë prej 6%. Kujdes i posaçëm i është dhënë zhvillimit të qasjes efikase për studentët me nevoja të posaçme si dhe mundësitë për bursa për këtë kategori studentësh.

9.2 Departamenti i ngrehinave dhe mjedisi në kampus

Në vitin 2010 u emërua drejtori i ri i Departamentit të ngrehinave dhe vazhduan përpjekjet për të përmirësuar punën në grup, duke filluar nga ristrukturimi i strukturës organizative për të përmirësuar menaxhimin e cilësisë, në mënyrë që menaxherëve t'ju jepet më shumë autoritet dhe për të siguruar hapësirë që drejtuesit e departamenteve të jenë të përfshirë në ekipin e punës së bashku me punëtorët dhe kjo filloi të implementohet. Stafi i Departamentit të ngrehinave është përfshirë në mënyrë aktive në

krijimin dhe zbatimin e procedurave bazuar në standardet ISO si dhe në procesin e zhvillimit për të përmirësuar cilësinë dhe performancën.

Universiteti vazhdoi të jetë një shembull në rajon dhe më gjerë në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe të kursimit të energjisë që kontribuon për shëndetin e studentëve dhe të komunitetit më të gjerë. Shumë përpjekje janë bërë në aspektin e kursimit të energjisë, sidomos në sistemin e ngrohjes dhe të konsumit energjisë elektrike, që është reduktuar në masë të madhe, me qëllim që të bëhet një kampus zero emetim. Planveprimi klimatik (PVK) i Universitetit u publikua në ueb faqen e universitetit dhe besohet se UEJL është i pari universitetit në Ballkan, ndoshta edhe universiteti i parë evropian me një plan të tillë. PVK përfaqëson një mjet të fuqishëm për të reduktuar gjurmët e karbonit në UEJL, që kanë për qëllim ndjekjen e implementimit të strategjive dhe një afat kohor për reduktimin e emisioneve të gazit serrë. Për më tepër lejon ndjekjen e qëllimeve të integritit të qëndrueshmërisë dhe veprimit klimatik në të gjitha aspektet hulumtim, mësimdhënie dhe kontakt me komunitetin në terren. UEJL ka vazhduar të sigurojë udhëheqje praktike dhe morale në lidhje me përpjekjet e shoqërisë për të trajtuar ndryshimin klimatik duke ndërmarrë hapa për të zvogëluar emetimet në kampus. Planveprimi klimatik i UEJL-së është plan strategjik dhjetëvjeçar për mënyrën se si kampusi do të ndërmarrë hapa për neutralizimin e karbonit. Ndërtesa 304 është pilot projekt për ndërtesën që përdor burime të riptërtrishme të energjisë, si panelet fotovoltaike dhe përdorimi i burimeve gjeotermale. Ky projekt është mbështetur nga qeveria italiane dhe pritet të hapet në fillim të vjeshtës 2011.

Ndërtesat origjinale në kampus kanë shënuar vitin e nëntë me shenja gjithnjë e në rritje për riparim. Mirëmbajtja e ndërtesave dhe mjedisit është e kënaqshme, por kostot e mbajtjes së këtyre objekteve të vjetra vazhdojnë të rriten. Hapa të rëndësishëm janë marrë në aspektin e rindërtimit dhe të përpunimit të ujit të pijshëm për konviktet e studentëve dhe lysterja e fasadave të jashtme. Ndërtesa 701 u rikonfigurua për t'i shërbyer më mirë qëllimit të mësimin në distancë.

9.3 Dega Shkup e Universitetit të Evropës Juglindore

Dega - Shkup e Universitetit të Evropës Juglindore (UEJL Shkup) po hyn në vitin e tretë të veprimit në mesin e kryeqytetit të Maqedonisë. Kombinimi i vendndodhjes tërheqëse e të përshtatshme me reputacionin e fortë të UEJL-së si institucion cilësor i arsimit të lartë, vazhdon të tërheqë studentët, pavarësisht numrit të madh të institucioneve lokale alternative dhe krizës ekonomike në vazhdim. Tri vitet e para kanë vënë në pah ndryshime dhe rolin e këtyre ndryshimeve mes degës - Shkup dhe kampusit të universitetit në Tetovë. Fizikisht, ndërtesa UEJL Shkup është shumë më e vogël. Përmasat e grupeve të studentëve varen nga përmasat e sallave (tipike 20-30 studentë në grup); shërbimet administrative janë të kufizuara nga hapësira e zyrave dhe numri i vogël i stafit administrativ me kohë të plotë (katër të punësuar); si dhe hapësira e vogël për studentët jashtë orëve të mësimin. Megjithatë kufizimet në hapësirë, stafi administrativ i UEJL Shkup siguron shërbime të shpejta, efektive, koordinon aktivitetet me zyrat përgjegjëse në kampusin e universitetit në Tetovë (përfshirë, Shërbimet studentore dhe të bursarit, dekanatet, Shërbime e bibliotekës,

Unionit studentor etj), duke reduktuar kështu nevojën e studenteve për të udhëtuar në Tetovë për këto shërbime.

Së bashku me kampusin e Universitetit në Tetovë, UEJL Shkup realizon vlerësime vjetore të studentëve. Duke marrë parasysh rrethanat unike të Degës - Shkup, në dy vitet e fundit, stafi lokal administrativ ka punuar bashkë për të modifikuar versionin e pyetësorit të përdorur në Shkup. Rezultatet e pyetësorit 2010-2011 ishin tepër informative. Shërbimet studentore: përgjithësisht rezultatet e këtij seksioni ishin inkurajuese, me përgjigje në të gjitha fushat; mbi të gjitha binte në sy- shërbimet në përgjithësi dhe sjellja e stafit administrativ, më e lartë se përgjigjja e studentëve në Tetovë. E kundërta ishte për kënaqësinë e studentëve me orarin (kënaqësia ishte më e ulët në Shkup se në Tetovë); gjithsesi duhet përmendur se organizimi i orarit realizohet në kushte më të mira në Tetovë). Duhet theksuar se orari i studentëve për UEJL - Shkup menaxhohet në Tetovë. Meqenëse UEJL - Shkup nuk ka një bibliotekë të mirëfilltë, pyetësorit iu shtua një numër i madh pyetjesh rreth bibliotekës. Rezultatet përgjithësisht nuk ishin shumë të këqija. Gjithsesi ato tregojnë një nivel përgjithësisht të ulët të kënaqësisë krahasuar me kampusin e Universitetit në Tetovë. UEJL Shkup është një qendër e frekuentuar. Si pasojë e mungesës së hapësirës, orari është zakonisht i ngjeshur në 6 ditë mësimi gjatë javës prej 08.00-20.00 . T'i mbash ambientet funksionale dhe të pastra është një sfidë e përditshme. Prandaj është shpërblyese të shohësh se kënaqësia e studentëve me pjesën e mirëmbajtjes, pastrimit dhe sigurisë ishte e lartë, në fakt më e larta se çdo pjesë e pyetësorit (si dhe në mënyrë të konsiderueshme më të larta se rezultatet ekuivalente në Tetovë). E vetmja fushë ku rezultatet ishin jo të kënaqshme ishte zhurma në objekte.

U tregua se ekziston një qasje proaktive ndaj mirëmbajtjes së objekteve. Përmes kontrolleve të hollësishme, të rregullta dhe të shpeshta të objekteve të UEJL-Shkup, impakti i çështjeve të mirëmbajtjes (p.sh. çështje hidraulike, e elektricitetit, pajisjeve të IT) është reduktuar. Përforcimi i shërbimeve administrative, po ashtu, është i dukshëm. Për përmirësimin e shpejtësisë dhe efektivitetit të shërbimeve administrative dhe lehtësimin e mungesës së stafit në punë, u ndërморën dy veprime. Së pari, ekipi lokal punoi më afër duke koordinuar punën në disa shërbime kyçe dhe së dyti, ekipi krijoi dhe implementoi një program trajnimi për studentët e programit "Puno dhe studio." Shërbimet e bibliotekës: efektshmëria e shërbimeve u rrit ndjeshëm nga prezenca e një përfaqësuesi part-time nga biblioteka e universitetit. Përmirësime të mëtejshme priten të ndodhin me hapjen e një leximoreje/degë e bibliotekës në qendrën e Shkupit gjatë semestrit dimëror 2011-2012.

9.4 Burimet njerëzore

Zyra e burimeve njerëzore (ZBNJ), në përputhje me planin e veprimit dhe prioritetet e parapara për vitin akademik ishte në qendër të shumë iniciativave të mëdha. Siç përmendet në vende të tjera në këtë raport, në universitet është miratuar dhe është implementuar Rregullorja për rangim, rroga dhe kompensime, e

cila u prezantua gradualisht gjatë vitit akademik me mbështetjen e vazhdueshme të QAM. Rregullorja e re ka prekur të gjitha aspektet e misionit akademik të universitetit, nga numri i lëndëve që instruktorët ligjërojnë, pagat, mentorimin, zhvillimin e stafit, etj. Për më tepër ZBNJ, përpiloi doracakun për stafin, i cili, për herë të parë, solli së bashku në një vend të përshtatshëm të gjitha politikat, procedurat dhe rregullat që mbulojnë të drejtat dhe përgjegjësitë e stafit të UEJL-së. ZBNJ ishte e përfshirë në krijimin e proceseve dhe dokumenteve të reja, duke përfshirë: formularët e aplikimit për punë, format vlerësimit të stafit, hartimin e rregulloreve për evidencë elektronike në bashkëpunim me Shërbimin juridik, hartimin e procedurave për rekrutimin, vlerësimin dhe trajnimin e stafit (këto procedura janë të përpunuara dhe të përgatitura për ISO me përfaqësuesit e emëruar nga sekretari i përgjithshëm – shërbimi për sigurimin e cilësisë), hartimin e procedurës për rekrutimin intern. Së fundi, HRO ka përfunduar përkrahimin e vendeve të punës për stafin administrativ në tri gjuhë. ZBNJ ka punuar nga afër me QAM dhe Qendrën për përkrahje të mësimdhënies për të koordinuar një gamë të plotë të aktiviteteve trajnuese për stafin administrativ dhe akademik. Si për vitet e mëparshme, i gjithë stafi u inkurajua për të rinovuar dhe për të rritur kompetencat gjuhësore angleze, njohuritë dhe përdorimin e TI. Stafi ndërkombëtar u angazhua aktivisht në studimin e gjuhëve shqipe dhe maqedonase. Për shkak të ngrirjes në punësimin për pozita të reja gjatë këtij viti, numri i anëtarëve të stafit administrativ ka shënuar rënie gjatë vitit. Bordi i universitetit ka sjellë vendim për ngrirje të përgjithshme të punësimit në fillim të vitit akademik. Universiteti ka vazhduar të bëjë përparim të mirë në çështjet e personelit akademik. Stafi akademik nga jashtë rajonit ka luajtur një rol të rëndësishëm në universitetin dhe për herë të parë, një shtetas jo-maqedonas u zgjodh dekan i një fakulteti. Universiteti ka vazhduar të favorizojë stafin akademik me orar të plotë duke lejuar fleksibilitet më të madh në drejtim të planifikimit dhe angazhimit për misionin e universitetit. Megjithatë, stafi akademik me kohë të pjesshme ishin të angazhuar sipas nevojës. Siç mund të shihet në tabelën më poshtë, numri i doktorëve të shkencës në rangje të ndryshme është dhënë gjatë periudhës trevjeçare.

Stafi akademik me orar të plotë (2008,2009, 20011)

	2009		2010		2011	
Stafi akademik		Numri i anët. stafit		Numri i anët. stafit		Numri i anët. stafit
PhD		91		100		145
MA		99		98		98
BA		58		39		18
Gjithsejtë		248		237		261

Analiza për stafin administrativ bazuar në kualifikimet akademike tregon se në vitin 2010 - 2011 Universiteti vazhdon për të inkurajuar të gjithë stafit të vazhdojnë arsimimin e tyre formal. Shumë anëtarë të stafit administrative në UEJL janë regjistruar në programet e ciklit të 2 në universitet dhe të përdorin përvojën e tyre profesionale dhe aktivitetet ditore, ti përdorin simjetet në hulumtimet e tyre akademike.

Stafi administrativ	2009		2010		2011	
		Numri i anët. stafit		Numri i anët. stafit		Numri i anët. stafit
PhD		5		5		7
MA		13		17		19
BA		65		74		70
Të tjerë		45		37		33
Gjithsejtë		128		133		129

9.5 Sistemet e informacionit

Vitin e kaluar akademik janë regjistruar ndryshime të mëdha dhe suksese në sferën e

IT në universitet. Nevojat e identifikuara më parë për këmbimin e informacionit në të

gjitha proceset e universitetit, si dhe përpjekjet e vazhdueshme për të krijuar një kulturë për përfshirjen dhe bashkëpunimin efikas ka rezultuar me një gurthemel të ri në Sistemin e IT të universitetit.

Me qëllim që të elektronizohet rrjedha e proceseve dhe e procedurave, u instalua, u konfigurua dhe u zhvillua një platformë SharePoint me Nintex. Si rezultat i kësaj, portali <https://i.seeu.edu.mk> u prezantuan dhe tre module/procedura dhe kjo u implementua. Procedura për prokurim (<https://i.seeu.edu.mk/sites/procurement>), e cila ishte më e komplikuar në nivel universitetit, hyri në pilot fazën. Një përparim i tillë mundësoi menaxhmentin të ketë qasje në raportet aktuale për pranimin e studentëve. Prezantimi i portalit <https://my.seeu.edu.mk>, si zëvendësim për shërbimet e vjetra, mundësoi që universiteti të ketë një pikë të vetme të shërbimit, ku studentët, fakulteti dhe stafi të kenë qasje në informata dhe shërbimet e tyre të mësimdhënies.

Funksioneve të reja në këtë Portal u janë shtuar: transkripta elektronike dhe bilanci financiar, resetimi i fjalëkalimit të email-it dhe llogarisë (nëpërmjet sms, mail-it, drejtpërdrejtë), Unified Messaging System moduli i njoftimit, sistemi i centralizuar për lajme, vlerësimi elektronik i stafit, moduli i ri i aplikacionit për regjistrimin e orarit dhe prezencën në orë. Për të mbështetur përdorimin e IT shërbimeve një modul i veçantë, Help Desk, u shtua në MyPortal. Si pjesë e përpjekjeve për të përmirësuar shërbimet për studentët dhe të përpunimit të transfereve dhe reregjistrimin, moduli STRM (Student Transfer and Re Registration modul) u prezantua si një pjesë University Management System. Për të rritur efikasitetin e planifikimit të burimeve në universitet, pastaj përmirësimin e transparencës dhe rritjen e efikasitetit në zonat ku departamentet e burimeve njerëzore dhe financave ndërveprojnë, është vendosur një zgjidhje ERP.

Për të ruajtur pozicionin udhëheqës të universitetit në ndjekjen e standardeve më të fundit në përmirësimin e performancës së sistemit dhe rritjen e sigurisë në të njëjtën kohë është bërë një përmirësim i konsiderueshëm i sistemit (zëvendësimi kompjuterëve dhe përditësimi i teknologjisë për sistemin). Për të përmirësuar qëndrueshmërinë e menaxhimit të burimeve të Departamentit të IT, shërbime të ndryshme si menaxheri virtual i i makinës, menaxhimi i ndryshimeve, menaxhimi e aseteve u prezantuan. Sa i përket sigurisë dhe mbulimit me rrjetë një varg ndryshimesh dhe përmirësimesh për zgjerim janë bërë në infrastrukturën e rrjetit. U prezantua teknologjia e fundit për mbrojtje të uebit u dhe u rrit ndjeshëm mbulimi me wireless rrjet. Pajisje shtesë janë shtuar në rrjet për të mbështetur sistemin Smart Card RFID.

Këto përmirësime në Departamentin e TI-së në vitin e kaluar akademik paraqesin një gur themeli të shëndoshë për ndërtimin e mëtejshëm të shërbimeve në vitet e ardhshme me qëllim të ndjekjes dhe të sigurimit të mbështetjes së nevojshme në teknologji për studentët dhe stafin drejt realizimit të misionit të universitetit.

9.6 Biblioteka

Biblioteka "Maks van der Shtul" vazhdoi të luajë një rol qendror në jetën akademike të studentëve, stafit dhe komunitetit më të gjerë. Lidërshipi i bibliotekës u konsolidua në këtë periudhë. Stafi profesional ka punuar me studentët dhe stafin akademik për të përmbushur nevojat e hulumtimit dhe shpërndarjen e përmbajtjes. Gjatë periudhës së orientimit, anëtarët e stafit të bibliotekës kanë udhëhequr turne për të gjithë studentët e ardhshëm. I gjithë stafi akademik u inkurajua të kërkojë nga studentët e tyre që në mënyrë aktive të bëjnë kërkime në bibliotekë. Gjatë kësaj periode biblioteka vazhdoi të shtojë fondin me burime elektronike. Biblioteka gjithashtu filloi të ofrojë shërbimet e saj në Qendrën UEJL-Shkup.

9.7 Unioni i studentëve

Unioni i studentëve ka vazhduar të shfrytëzojë mundësitë dhe të luajë rol në jetën universitare. Unioni ka përfaqësuar në të gjitha organet/mbledhjet e universitetit (bord, senat, Këshill të rektorit), me shkallë të ndryshme të prezencës dhe të pjesëmarrjes. Unioni i studentëve ka organizuar një numër të ngjarjeve argëtuese gjatë vitit dhe Euro- trip. Kohët e fundit, sipas ekzekutivit të unionit kanë filluar përgatitjet për rishikimin e Statutit dhe zhvillimin e një strukture të re, me parlamentin dhe zyrtarët e zgjedhur në mënyrë demokratike, me një plan të aktiviteteve që u përshtaten të gjithë studentëve. Ky veprim ka për qëllim të forcojë menaxhimin financiar të buxhetit të ofruara nga Universiteti. Kjo punë është në vazhdim e sipër.

9.8 Departamenti i sportit dhe rekreacionit

Departamenti i sportit dhe rekreacionit ishte aktiv gjatë vitit në organizimin e ngjarjeve sportive për studentët dhe stafin. Departamenti i sportit dhe rekreacionit ka organizuar aktivitete alpinizmi në Malin Sharr në majat që janë mbi kampusin e UEJL në Tetovë, si dhe turne në futboll, tenis dhe volejball. Gjatë muajit mars, departamenti organizoi dhe ishte nikoqir i garës vjetore në skijim për universitetet rajonale. Departamenti ka mbështetur iniciativat e studentëve dhe stafit për zgjerimin e objekteve, duke përfshirë mundësinë për ndërtimin e një sale të re sportive. Për herë të parë në vitin 2010-2011, departamenti ka ofruar lëndë zgjedhore pa kredi për të gjithë studentët në programet deridiplomike. Gjatë këtij pilot programi, plani mësimor dhe metodologjik për të ligjëruar këtë lëndë është rishikuar.

10.0 Konkluzionet

Universiteti i Evropës Juglindore ka vazhduar ta përmirësojë cilësinë e mësimdhënies dhe nxënies gjatë kësaj periode, në mënyrë të veçantë në këtë aspekt ka ndihmuar vlerësimi i jashtëm i katër nga pesë fakultet e universitetit. Këto vlerësime të jashtme kanë ofruar analizë të thellë të programeve aktuale, si dhe këshilla strategjike për të siguruar që universitetit të mbetet në krye të arsimit të lartë në Maqedoni. Stafi akademik dhe administrativ vazhdoi të ofrojë energjinë dhe potencialin e tyre intelektual për universitetin dhe ka ofruar mbështetje të plotë për ekipin e ri të menaxhmentit. Fakultetet, qendrat, dhe njësitë administrative u përfshirë në mënyrë aktive në krijimin e planeve të veprimit dhe në implementimin e tyre gjatë vitit. E rëndësishme, ishte cilësia si element kyç në këto plane dhe kjo ka vazhduar të jetë prioritet në të gjitha lëmenjtë në universitet. Universiteti i Evropës Juglindore ka përparuar në dekadën e fundit, ndonëse në rrethana të vështira. Ky institucion i rëndësishëm arsimor është i përgatitur edhe për një dekadë të jetë në shërbim të studentëve, për palët e interesuara (stakeholders) dhe për komunitetin.

Materialet që janë konsultuar:

Raport për regjistrimet, kalueshmërinë, progresin akademik dhe arritjet 2011, tetor 2011, përgatitur nga Shërbimi për studentë

Raporti për regjistrimet, progresin akademik dhe arritjet në ciklin e dytë të studimeve , 2005.2006 - 2010/2011, shtator 2011, përgatitur nga Zyra për planifikim akademik, 2nd Cycle Studies Office

Plan veprimet për fakultetet dhe qendrat 2010-2011

Plan veprimet e prorektorëve 2010-2011

Raporti i vlerësimit të jashtëm për fakultetin e SHTB (Mathew Palakal), shkurt 2011

Raporti i vlerësimit të jashtëm për fakultetin e BE (Venkat), qershor 2011

Raporti i vlerësimit të jashtëm për fakultetin e APSHP (William Dunn), janar 2011

Raporti i vlerësimit të jashtëm për Fakultetin e juridik (University of Graz - W. Benedekt), shkurt 2011

Raport për vëzhgimin e mësimdhënies, viti akademik 2010-2011, SEEU QAM Office, shtator 2011

Raport përmbledhës për vlerësimin nga studentët 2010-11, SEEU QAM Office, tetor 2011

Raporti vjetor i universitetit për vitin akademik 2009/2010, Prorektori për çështje akademike, nëntor 2010

Plan veprimi klimatik, SEEU IEH, maj 2011

Anëtarët e komisionit për vetë-vlerësim

- Poul Foster, kryetar;
- Xhevahir Mehmeti, zëvendëskryetar
- Hedher Henshou,
- Henri Dikson,
- Z. Abaz Selmani,
- Mehmet Mehmeti, APSHP
- Bekim Fetahu, SHTB
- Ismail Zejneli, Juridik
- Hristina Cipunseva, FBE
- Andriu Godspid, GJKK,
- Lejla Abazi, Qendra për E-Learning,
- Veronika Kareva, QGJ
- Z-nj. Behare Qerimi-Mbështetje teknike